LIGJ
Nr. 126/2014

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË GARANCISË SOVRANE DHE TË ZHDËMTIMIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, BANKËS VSEOBECNA UVEROVA BANKA, A.S., SLLOVAKI, DHE INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA, SH.A., PËR KUNDËRGARANCINË E BANKËS VSEOBECNA UVEROVA BANKA, A.S., SLLOVAKI, PËR MARRËVESHJEN E GARANCISË BANKARE NDËRMJET OPERATORIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, SH.A. DHE BANKËS VSEOBECNA UVEROVA BANKA, A.S., SLLOVAKI, DHE PËR MARRËVESHJEN E HUAS NDËRMJET OPERATORIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, SH.A. DHE INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA, SH.A.

Në mbështetje të neneve 78, 83, pikat 1 e 2, 84, pika 4, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e garancisë sovrane dhe e zhdëmtimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, bankës Vseobecna Uverova Banka, a.s., Sllovaki, dhe Intesa Sanpaolo Bank Albania, sh.a., për kundërgarancinë e bankës Vseobecna Uverova Banka, a.s., Sllovaki, për marrëveshjen e garancisë bankare ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, sh.a., dhe bankës Vseobecna Uverova Banka, a.s., Sllovaki, dhe për marrëveshjen e huas ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, sh.a., dhe Intesa Sanpaolo Bank Albania, sh.a., sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar në datën 25.9.2014

GARANCI SOVRANE DHE ZHDËMTIM
Datë _____ 2014

Republika e Shqipërisë
(Garantuesi)
Všeobecná úverová banka, a.s.,
Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a.
(Përfituesit)

Ky dokument i garancisë sovrane dhe zhdëmtimit ("Garancia Sovrane") lidhet më _____ 2014 nga dhe ndërmjet:

1. Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Ministri i Financave si garantues ("Garantuesi");

2. Všeobecná Úverová Banka a.s., e themeluar dhe regjistruar në Republikën e Sllovakisë me numër shoqërie 31 32 01 55 zyra e regjistruar e së cilës është në Bratislava, Mlynské nivy 1, Kodi Postar 829 90, Sllovaki, regjistruar në Gjykatën e Rrethit në Bratislava 1, në seksionin Sa, hyrja nr. 341/B ("VUB"); dhe

3. Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a., me numër regjistrimi NIPT J81817006P dhe zyrë të regjistruar në Rr. "Ismail Qemali", nr. 27, Tiranë, Shqipëri ("ISBA").

Hyrje

A. Sipas një marrëveshjeje pajtimi ("Marrëveshje Pajtimi") e lidhur më 23 qershor 2014 ndërmjet, *inter alia*, "Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike" sh.a., një shoqëri e themeluar në Shqipëri dhe regjistruar në Regjistrin Tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit me numër unik identifikimi (NUIS) K72410014H, zyra e regjistruar e së cilës është te Njësia Bashkiake nr. 5, Rr. "Andon Zako Cajupi", Pallati Conad, kati i 3-të, Tirana, Republika e Shqipërisë ("OSHEE sh.a.") dhe ČEZ a.s., e themeluar dhe regjistruar në Republikën Çeke me numër identifikimi të Shoqërisë 45274649, zyra e regjistruar e së cilës është te Praha 4, Duhová 2/1444, kodi postar 14053, Republika Çeke, e regjistruar në Regjistrin Kombëtar që mbahet nga Gjykata Bashkiake në Pragë Seksioni B, Hyrja 1581 ("CEZ"), OSHEE sh.a. mori përsipër t'i bëjë disa pagesa CEZ-it në datat e specifikuara këtu.

B. Bazuar në garancinë bankare dhe zhdëmtimin të nënshkruar më _____ 2014 nga VUB, cilësinë e tij si garantues, dhe CEZ-i, në cilësinë e tij si përfitues ("Garancia Bankare"), VUB-i merr përsipër të garantojë

pagesa të caktuara që OSHEE sh.a. i ka CEZ-it sipas Marrëveshjes së pajtimit, me marrjen e kërkesës së parë me shkrim nga CEZ-i që deklaron që OSHEE sh.a. nuk ka bërë pagesën përkatëse sipas Marrëveshjes së Pajtimit dhe pagesa përkatëse ka mbetur e pashlyer pas skadimit të afatit të zbatueshëm pa pagesa;

C. Bazuar në një depozitim të një marrëveshjeje mbitërheqjeje nr _____, indeks nr. _____, të lidhur më _____ 2014 ndërmjet ISBA-së dhe OSHEE sh.a. ("Marrëveshja e Huas"), ISBA-ja bie dakord t'i ofrojë OSHEE sh.a. një mundësi mbitërheqjeje si instrument kredie që i jepet OSHEE sh.a.vetëm për qëllimin e përmbushjes së detyrimeve të caktuara të pagesës sipas Marrëveshjes së Pajtimit.

D. Një prej kushteve që Garancia Bankare të hyjë në fuqi është marrja nga VUB-i i Garancisë Sovrane të lëshuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe i aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë;

E. Për më tepër, dispozitat e Marrëveshjes së Huas kërkojnë si parakusht për përdorimin e mbitërheqjes nga OSHEE sh.a.lëshimin e kësaj Garancie Sovrane nga Këshilli i Ministrave (të aprovuar nga Kuvendi i Shqipërisë) për qëllimin e sigurimit të përmbushjes së detyrimeve të OSHEE sh.a. që rrjedh nga Marrëveshja e Huas;

F. Në lidhje me sa më sipër, Këshilli i Ministrave të Shqipërisë ka vendosur të lëshojë këtë Garanci Sovrane me vendimin nr. _____, datë _____ 2014 "Mbi aprovimin e garancive qeveritare" në favor të VUB-it dhe ISBA-së, me qëllim që: i) të rigarantojë detyrimet e garancisë dhe zhdëmtimit të VUB-it sipas Garancisë Bankare, si dhe të garantojë përmbushjen me saktësi nga OSHEE sh.a. të detyrimeve të pagesave sipas Marrëveshjes së Lëshimit të Garancisë Bankare (të përkufizuar më poshtë) dhe Marrëveshjes së Huas; dhe ii) të zhdëmtojë, si i detyruar primar, VUB-in dhe ISBA-në ndaj çdo kostoje, humbjeje ose detyrimi as VUB-i dhe/ose ISBA-ja mund të pësojë në përmbushje të detyrimeve të tyre sipas Garancisë Bankare dhe/ose Marrëveshjes së Huas, përkatësisht.

G. Lëshimi i kësaj Garancie Sovrane, sipas temave dhe kushteve të saj, është aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë më _____, me ligjin nr _____, datë _____.

Kështu, bihet dakord si më poshtë:

1. PËRKUFIZIME

1.1 Termat e përkufizuar

1.1.1 Në këtë Garanci Sovrane, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

"Marrëveshja për Lëshimin e Garancisë Bankare" është marrëveshja e përfunduar më _____ ndërmjet VUB-it dhe OSHEE sh.a. sipas së cilës VUB-i ra dakord të lëshojë Garancinë Bankare dhe OSHEE sh.a. mori përsipër t'i paguajë VUB-it koston e Garancisë Bankare, nëse ekzekutohet garancia bankare, shumën e Garancisë Bankare;

"Garanci Bankare" është garancia bankare dhe zhdëmtimi i përkufizuar në hyrjen B;

"Shuma e Garancisë Bankare" është shuma që nuk kalon 86,000,000.00 (tetëdhjetë milionë euro) e garantuar nga VUB-i sipas Garancisë Bankare;

"Kostoja e Garancisë Bankare" është shuma e plotë e kostos dhe tarifave që i paguhen nga OSHEE sh.a. VUB-it sipas Marrëveshjes për Lëshimin e Garancisë Bankare;

"Përfituesit" janë VUB-i dhe ISBA;

"Ditë Pune" është një ditë (e ndryshme nga e shtuna, e diela ose një festë zyrtare në Pragë, Bratislava dhe Tiranë) kur bankat në Republikën Çeke, Republikën Sllovake dhe në Republikën e Shqipërisë janë të hapura për aktivitetin e përgjithshëm dhe që është një ditë TARGET 2;

"CEZ" është shoqëria e përkufizuar në hyrjen A;

"OSHEE sh.a." është shoqëria e përkufizuar në hyrjen A dhe/ose pasuesi i saj që ka licencën e shpërndarjes së energjisë elektrike dhe që është pronari i sendeve pasurore të shpërndarjes;

"Kërkesë" është kërkesa e parë me shkrim për pagesë e bërë nga VUB-i ose ISBA-ja drejtuar Garantuesit në pajtim me dispozitat e klauzolës 2 më poshtë thelbësisht në formën e parashikuar në grafikun 1;

"Kostot e Ekzekutimit" janë të gjitha detyrimet dhe shpenzimet e pësuara nga VUB-i dhe/ose ISBA-ja në lidhje me ekzekutimin ose ruajtjen e të drejtave të VUB-it dhe/ose ISBA-së sipas kësaj Garancie Sovrane (duke përfshirë çdo tarifë ose kosto gjyqësore);

"Dokumente Financiare" është Garancia Bankare, Marrëveshja e Huas, Marrëveshja e Pajtimit, Marrëveshja për Lëshimin e Garancisë Bankare dhe të kësaj Garancie Sovrane;

"Shuma e Garantuar" është shuma e: i) gjendjes së mbetur përfundimtare të Shumës së Garancisë Bankare dhe Shumës së huas që në çdo rast nuk kalojnë EUR 86,000,000.00 (tetëdhjetë e gjashtë milionë euro); ii) Kostos së Garancisë Bankare; iii) Kostos së Huas; dhe iv) Kostos së Ekzekutimit;

"Shuma e Huas" është shuma principale e mbitërhequr prej 3,045,000,000 ALL (tre miliardë e dyzet e pesë milionë ALL) që i jepen nga ISBA OSHEE sh.a. në pajtim me Marrëveshjen e Huas;

"Marrëveshja e Huas" ka kuptimin që i vishet në hyrjen C;

"Kosto të Huas" është shuma e përgjithshme e interesave, gjobave, shpenzimeve dhe tarifave të pagueshme nga OSHEE sh.a. ISBA-së sipas Marrëveshjes së Huas;

"Palët" janë Republika e Shqipërisë, VUB-i dhe ISBA-ja si palë të kësaj Garancie Sovrane;

"Subjekt Publik" është:

a) çdo departament, ministri ose agjenci e qeverisë së Republikës së Shqipërisë; ose

b) çdo korporatë, trust, institucion financiar ose subjekt tjetër në pronësi ose nën kontrollin (do të thotë pushtet, i drejtpërdrejtë ose jo i drejtpërdrejtë, nëpërmjet pronësisë së aksioneve votuese ose interesave të tjera pronësore apo ndryshe, për të drejtuar menaxhimin ose për të zgjedhur apo emëruar një shumicë të bordit të drejtorëve ose personave të tjerë që kryejnë funksione të ngjashme në mungesë ose përveç bordit të drejtorëve të një korporate, trusti, institucioni financiar apo subjekti tjetër) e qeverisë së Republikës së Shqipërisë (duke përfshirë OSHEE sh.a.);

Mjet i Sigurimit të Padisë është hipoteka, barra, pengu, e drejtë mbajtjeje ose një mjet tjetër sigurimi të padisë që siguron një detyrim të një personi ose një marrëveshje tjetër ose masë që ka efekt të ngjashëm.

Marrëveshje Pajtimi ka kuptimin që i vishet në hyrjen A;

Ditë TARGET 2 është një ditë në të cilën sistemi i pagesave Trans-European Automated Real-time Gross Settlement Express Transfer (i iniciuar më 19 nëntor 2007 dhe që përdor një platformë të vetme të përbashkët) është e hapur për shlyerjen e pagesave në euro.

1.2 Interpretimi

1.2.1 Në këtë Garanci Sovrane, zbatohen rregullat e mëposhtëm të interpretimit:

a) Një referencë në një person përfshin referencën te një individ, firmë, shoqëri, korporatë, partneritet, strukturë e pathemeluar e personave, qeveri, shtet ose agjenci shtetërore ose çdo shoqatë, trust, ndërmarrje e përbashkët ose konsorcium (pavarësisht nëse ka një personalitet të veçantë juridik) dhe te përfaqësuesit, pasuesit transferimet e lejuara ose të transferuarit e lejuar të atij personi;

b) përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, fjalët në njëjës përfshijnë shumësin dhe në shumës përfshijnë njëjësin;

c) përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, një referencë te një gjini përfshin një referencë te gjinitë e tjera;

d) një referencë tekVUB-i dhe/ose ISBA-ja përfshin pasuesit ose të transferuarit e tyre përkatës;

e) një referencë me shkrim ose e shkruar përfshin dokumentin origjinal;

f) një referencë te kjo Garanci Sovrane (ose dispozitë e saj) ose te një marrëveshje apo dokument tjetër i referuar në këtë Garanci Sovrane është një referencë te kjo Garanci Sovrane ajo dispozitë apo ajo marrëveshje apo dokument tjetër i ndryshuar (në çdo rast, përveç se në shkelje të dispozitave të kësaj Garancie Sovrane) herë pas here;

g) përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, një referencë te një klauzolë ose grafik është referencë te një klauzolë ose grafik i kësaj Garancie Sovrane;

h) çdo fjalë pas termave duke përfshirë, përfshin, veçanërisht, për shembull, ose një shprehje e ngjashme interpretohet si ilustrim dhe nuk e kufizon kuptimin e fjalëve, përshkrimit, përkufizimit, shprehjes ose termit që është para këtyre termave;

i) një referencë te një amendim përfshin një rishqyrtim, rihyrje në fuqi, shtesë ose ndryshim (dhe e amenduar interpretohet përkatësisht);

j) një referencë te sendet pasurore përshin pasurinë e tashme dhe të ardhme, sipërmarrjet, të ardhurat, të drejtat dhe përfitimet e çdo përshkrimi;

k) një referencë te një autorizim përfshin një aprovim, autorizim, pëlqim, përjashtim, depozitim, licencë, noterizim, regjistrim ose vendim;

l) një referencë te një rregullore përfshin një rregullore, rregull, direktivë zyrtare, kërkesë ose udhëzim (që ka ose nuk ka fuqinë e ligjit) e një organi, agjencie ose departamenti qeveritar, ndërqeveritar dhe suprakombëtar, ose autoriteti apo organizate rregullatore, vetërregullatore ose tjetër; dhe

m) Hyrjet e kësaj Garancie sovrane përbëjnë pjesë integrale të kësaj;

n) Titujt e klauzolave nuk ndikojnë në interpretimin e kësaj Garancie Sovrane;

1.3 Të drejtat e Palëve të Treta.

1.3.1 Nëpunësit, të punësuarit dhe agjentët përkatës të çdo Përfituesi mund të ekzekutojnë çdo term të kësaj Garancie Sovrane që synon dhënien e një përfitimi për atë person, por asnjë person tjetër i cili nuk është Palë në këtë Garanci Sovrane nuk ka të drejtë sipas ligjit të kontratave (të drejtat e Palëve të Treta) të vitit 1999 të ekzekutojnë ose gëzojnë përfitimet e një termi të kësaj Garancie Sovrane.

1.3.2 Pavarësisht nga ndonjë term në këtë Garanci Sovrane, Palët në këtë Garanci Sovrane mund të anulojnë, ndryshojnë, heqin dorë, lirojnë, transferojnë, riformulojnë ose disponojnë ndryshe mbi të gjitha ose një pjesë përkatëse të të drejtave ose detyrimeve të tyre sipas kësaj Garancie Sovrane pa pëlqimin e ndonjë personi që nuk është Palë në këtë Garanci Sovrane.

2. GARANCIA DHE ZHDËMTIMI

2.1. Garancia dhe zhdëmtimi

2.1.1 Në lidhje me shumën e GBP 1, marrja e së cilës konfirmohet nga Garantuesi, Garantuesi, në mënyrë të parevokueshme, të pakushtëzuar dhe të pavarur nga Dokumentet Financiare, merr përsipër:

a) të: i) rigarantojë garancinë dhe detyrimet për zhdëmtim të VUB-it sipas Garancisë Bankare; ii) garantojë VUB-it përmbushjen e saktë nga OSHEE sh.a. të të gjitha detyrimeve të saj sipas Marrëveshjes për Lëshimin e Garancisë Bankare; dhe iii) garantojë ISBA-në për përmbushjen e saktë të të gjitha detyrimeve nga OSHEE sh.a. sipas Marrëveshjes së Huas;

b) kundrejt VUB-it që kurdoherë që OSHEE sh.a. nuk paguan një shumë kur bëhet e kërkueshme në lidhje me një Dokument Financiar, Garantuesi, menjëherë pas Kërkesës së VUB-it (pavarësisht nëse paraqitet në momentin e caktuar të maturimit, me procedurë të përshpejtuar ose ndryshe) dhe deri në totalin e shumës së Garancisë Bankare, Kostos së Garancisë Bankare dhe Kostos së Ekzekutimit, e paguan këtë shumë sikur të ishte i detyruari kryesor;

c) kundrejt ISBA-së që kurdoherë që OSHEE sh.a. nuk paguan një shumë kur bëhet e kërkueshme në lidhje me një Dokument Financiar, Garantuesi, menjëherë pas Kërkesës së ISBA-së (pavarësisht nëse paraqitet në momentin e caktuar të maturimit, me procedurë të përshpejtuar ose ndryshe) dhe deri në totalin e Shumës së Huas, Kostos së Huas dhe Kostos së Ekzekutimit, e paguan këtë shumë sikur të ishte i detyruari kryesor;

d) si një detyrim të veçantë dhe të pavarur nga detyrimet e veta sipas 2.1.1(a) dhe (b) më sipër, të zhdëmtojë VUB-in plotësisht, menjëherë me kërkesën e VUB-it deri në totalin e Shumës së Garancisë Bankare, Kostos së Garancisë Bankare dhe Kostos së Ekzekutimit, ndaj çdo pretendimi, kostoje, humbjeje apo detyrimi të pësuar nga VUB-i që rrjedh nga ose në lidhje me Garancinë Bankare ose Marrëveshjen për Lëshimin e Garancisë Bankare, nëse një detyrim i garantuar/marrë përsipër prej tij është ose bëhet i paekzekutueshëm, i pavlefshëm ose i paligjshëm. Shuma e kostos, humbjes ose detyrimit është e barabartë me shumën që VUB-i do të kishte të drejtën ndryshe të përftonte sipas Garancisë Bankare dhe/ose Marrëveshjes për Lëshimin e Garancisë Bankare; dhe

e) si një detyrim të veçantë dhe të pavarur nga detyrimet e veta sipas 2.1.1(a) dhe (c) më sipër, të zhdëmtojë ISBA-në plotësisht, menjëherë me kërkesën e ISBA-së deri në totalin e Shumës së Huas, Kostos së Huas dhe Kostos së Ekzekutimit, ndaj çdo pretendimi, kostoje, humbjeje apo detyrimi të pësuar nga ISBA-ja që rrjedh nga ose në lidhje me Marrëveshjen e Huas nëse një detyrim i garantuar/marrë përsipër prej tij është ose bëhet i paekzekutueshëm, i pavlefshëm ose i paligjshëm. Shuma e kostos, humbjes ose detyrimit është e barabartë me shumën që ISBA-ja do të kishte të drejtën ndryshe të përftonte sipas Marrëveshjes së Huas.

2.1.2 Palët bien dakord që detyrimi i Garantuesit për garancinë dhe zhdëmtimin sipas Garancisë Sovrane është e kufizuar në shumën e garantuar.

2.1.3 Çdo Përfitues mund të ekzekutojë të drejtat e tij veçmas, plotësisht ose pjesërisht.

2.2 Garanci në vazhdim

Kjo Garanci Sovrane është një garanci në vazhdim dhe shtrihet deri në gjendjen e fundit të të gjitha shumave të pagueshme nga VUB-i CEZ-it sipas Garancisë Bankare, nga OSHEE sh.a. VUB-it sipas Marrëveshjes së Lëshimit të Garancisë Bankare ose nga OSHEE sh.a. ISBA-së sipas Marrëveshjes së Huas, pavarësisht nga ndonjë pagesë ose shlyerje e ndërmjetme e plotë ose e pjesshme.

2.3 Rivendosja

Nëse një pagesë nga OSHEE sh.a. ose një shlyerje e bërë nga një Përfitues ose një person tjetër (në lidhje me detyrimet e OSHEE sh.a. ose një Garanci për ato detyrime apo tjetër) shmanget ose zvogëlohet si rezultat i paaftësisë paguese ose i një ngjarjeje të ngjashme:

a) detyrimi i Garantuesit vazhdon sikur pagesa, shlyerja, shmangia ose zvogëlimi të mos ishte kontrolluar; dhe

b) çdo Përfitues ka të drejtë të përftojë vlerën ose shumën e asaj Garancie ose pagese nga Garantuesi, sikur pagesa, shlyerja, shmangia ose zvogëlimi të mos kishte ndodhur.

2.4 Heqja dorë nga mjetet e mbrojtjes

Detyrimet e Garantuesit nuk ndikohen nga asnjë veprim, mosveprim, çështje ose send që, nëse nuk do të ekzistonte kjo dispozitë, mund të vepronte për të ulur, liruar, ndikuar ose ndryshe liruar Garantuesin nga detyrimet e veta plotësisht ose pjesërisht, duke përfshirë pa kufizim dhe pavarësisht nëse janë të njohura ose jo për Garantuesin ose një Përfitues:

a) kurdoherë, heqjen dorë ose pëlqimin e dhënë ose pajtimin me OSHEE sh.a. ose një person tjetër;

b) lirimin e OSHEE sh.a. ose të një personi tjetër sipas termave të një pajtimi ose mase me një kreditor të OSHEE sh.a. ose një filial të OSHEE sh.a.;

c) marrjen, ndryshimin, kompromisin, shkëmbimin, rinovimin ose lirimin apo refuzimin ose neglizhencën për të përmbushur, filluar ose ekzekutuar një të drejtë ndaj ose Garancinë mbi sendet pasurore të OSHEE sh.a. ose një personi tjetër ose një mosprezantimi ose mosrespektimi të një formaliteti ose një kërkese tjetër në lidhje me një instrument ose një mosrealizim të vlerës së plotë të një Garancie;

d) çdo mungesë zotësie ose mungesë kompetence, autoriteti ose personaliteti juridik ose shkrirje ose ndryshim në anëtarët ose statusin e OSHEE sh.a. ose një personi tjetër;

e) çdo amendim, rinovim, shtojcë, zgjatje, rivendosje (sado themelore ose qoftë rënduese ose jo) ose zëvendësim i një Dokumenti Financiar ose një dokumenti tjetër ose Garancie duke përfshirë pa kufizim një ndryshim në qëllim, një zgjatje ose një rritje në një instrument ose shtesë të një instrumenti të ri sipas një Dokumenti Financiar ose një dokumenti tjetër ose Garancie;

f) një mosekzekutueshmëri, pavlefshmëri ose pengesë të një detyrimi të OSHEE sh.a. ose një personi tjetër sipas Dokumenteve Financiare ose një dokumenti tjetër apo Garancisë; ose

g) një paaftësi paguese, likuidim, administrim ose procedimi ngjashëm.

2.5 Rikuperimi i drejtpërdrejtë

Garantuesi heq dorë nga çdo e drejtë që mund të ketë për të kërkuar fillimisht që një Përfitues (ose një i besuar apo agjent në emër të tij) të veprojë ndaj ose të ekzekutojë një të drejtë ose Garanci tjetër ose të kërkojë pagesën nga OSHEE sh.a. ose një person tjetër para se të kërkojë nga Garantuesi. Kjo heqje dorë zbatohet pavarësisht nga ndonjë ligj ose dispozitë në një dokument financiar që parashikon të kundërtën.

2.6 Shumat e destinuara

Deri në momentin që të gjitha shumat që mund të jenë ose mund të bëhen të pagueshme nga OSHEE sh.a. sipas ose në lidhje me Dokumentet Financiare të jenë paguar plotësisht në mënyrë të pakthyeshme, çdo Përfitues (ose i besuar apo agjent në emër të tij) mund të:

a) mos zbatojë apo ekzekutojë fonde të tjera, Garanci ose të drejta që mbahen ose merren nga ai Përfitues (ose një i besuar apo agjent në emër të tij) në lidhje me ato shuma ose të zbatojë ose ekzekutojë këto në mënyrë dhe rend të tillë siç e sheh të arsyeshme (qoftë kundrejt atyre shumave apo ndryshe) dhe Garantuesi nuk ka të drejtë të përfitojë prej tyre; dhe

b) mbajë në llogari të ndërmjetme (pa qenë i detyruar të paguajë interesa për to) të gjitha fondet e marra nga Garantuesi ose për llogari të detyrimit të Garantuesit.

2.7 Pezullimi i të drejtave të Garantuesit

Deri në momentin që të gjitha shumat që mund të jenë ose mund të bëhen të pagueshme nga OSHEE sh.a. sipas ose në lidhje me Dokumentet Financiare të jenë paguar plotësisht në mënyrë të pakthyeshme, Garantuesi nuk ushtron asnjë të drejtë që mund të ketë për shkak të përmbushjes prej tij të detyrimeve sipas kësaj Garancie Sovrane ose një marrëveshjeje tjetër me OSHEE sh.a. ose për shkak të një shume që është e pagueshme, ose detyrimi që rrjedh në bazë të kësaj Garancie Sovrane:

a) për të marrë ose pretenduar pagesën ose të zhdëmtohet nga OSHEE sh.a.;

b) për të pretenduar një kontribut nga VUB-i ose një garantues tjetër ose dhënës i Garancisë në lidhje me detyrimet e OSHEE sh.a. sipas Dokumenteve Financiare;

c) për të përfituar (plotësisht ose pjesërisht dhe nëpërmjet transferimit ose ndryshe, ndonjë prej të drejtave të Përfituesit sipas Dokumentit Financiar ose të një garancie ose mjet sigurimi të vendosur në pajtim ose në lidhje me dokumentet financiare nga një Përfitues;

d) për të nisur procedura gjyqësore ose të tjerë për një urdhër që i kërkon OSHEE sh.a. ose VUB-it ose ISBA-së të bëjë një pagesë ose të përmbushë një detyrim, në lidhje me të cilin Garantuesi ka dhënë një garanci, ka marrë angazhim ose zhdëmtim sipas klauzolës 2;

e) për të ushtruar të drejtën e kompensimit kundrejt OSHEE sh.a. dhe/ose;

f) për të pretenduar ose provuar si kreditor i OSHEE sh.a. në konkurrencë me një Përfitues.

2.8 Mjet garancie shtesë

Kjo Garanci Sovrane është si shtesë dhe nuk cenohet në asnjë mënyrë nga ndonjë Mjet tjetër Sigurie që mbahet tani ose pas kësaj nga një Përfitues ose një person tjetër si Mjet Sigurie për detyrimet e OSHEE sh.a. sipas Dokumenteve Financiare.

2.9 Certifikata

Një certifikatë e Përfituesit në lidhje me një shumë të papaguar nga OSHEE sh.a. sipas një Dokumenti Financiar është provë përfundimtare për një shumë të tillë kundrejt Garantuesit.

2.10 Të drejtat e ndashme

Detyrimet e Garantuesit kundrejt çdo Përfituesi sipas kësaj Garancie Sovrane ekzistojnë të ndara për secilin prej tyre në pajtim me klauzolën 2.1.1. Çdo Përfitues mund të ekzekutojë të drejtat e tij veçmas, në pajtim me klauzolën 2.1.1.

2.11 Mungesa e mjetit të sigurimit

Deri në momentin që të gjitha shumat që mund të jenë ose mund të bëhen të pagueshme nga OSHEE sh.a. sipas ose në lidhje me Dokumentet Financiare të jenë paguar plotësisht në mënyrë të pakthyeshme, Garantuesi nuk merr ose mban ndonjë mjet sigurimi në lidhje me ndonjë prej detyrimeve të Garantuesit sipas kësaj Garancie Sovrane.

3. ANGAZHIME TË TJERA

3.1 Garantuesi bie po ashtu dakord në mënyrë të pakthyeshme dhe të pakushtëzuar, që nëse:

a) Garantuesi nuk përmbush një dispozitë të kësaj Garancie Sovrane;

b) çdo përfaqësim, garanci ose deklarim i bërë ose përsëritur në ose në lidhje me Garancinë Sovrane ose në një llogari, certifikatë, deklarim ose mendim të dhënë nga ose në emër të Garantuesit në pajtim me ose në lidhje me Garancinë Sovrane është e parregullt nëse bëhet ose mendohet të përsëritet;

c) një ngjarje e qenies në vonesë ndodh sipas një Dokumenti Financiar;

d) Garantuesi ose një Subjekt Publik deklaron ose vendos një moratorium në ose në lidhje me të gjithë ose një pjesë të qenies në borxh ose Garantuesi apo Subjekti Publik nuk është në gjendje të paguajë borxhet kur ata bëhen të kërkueshëm;

e) një autorizim, aprovim, pëlqim, licencë, përjashtim, depozitim, regjistrim, noterizim ose kërkesë tjetër (sipas rastit) e nevojshme për t'i mundësuar Garantuesit të përmbushë një prej detyrimeve të tij sipas kësaj Garancie Sovrane modifikohet, revokohet ose nuk jepet ose nuk mbetet në fuqi të plotë;

f) është në çdo rast e paligjshme për Garantuesin të përmbushë një prej detyrimeve të tij sipas kësaj Garancie Sovrane ose që Garantuesi të tërheqë këtë Garanci Sovrane ose të provojë synimin e tij për të tërhequr këtë Garanci Sovrane;

g) në çdo rast kjo Garanci Sovrane pushon që qeni në fuqi të plotë; ose

h) ndodhin rrethana të caktuara që në mendimin e arsyeshëm të Përfituesve mund të jetë e arsyeshme të pritet të ndikojë negativisht aftësinë ose vullnetin e Garantuesit të përmbushë të gjithë ose një prej këtyre detyrimeve,

atëherë Garantuesi, me Kërkesën e Përfituesit përkatës, i paguan Përfituesit përkatës të gjitha shumat që Përfituesi do të kishte të drejtë të rikuperonte sipas Dokumentit Financiar sikur Garancia Bankare dhe/ose Marrëveshja për lëshimin e Garancisë Bankare dhe/ose Marrëveshja e Huas të ishte bërë menjëherë e kërkueshme dhe e pagueshme në momentin e kërkesës.

4. PAGESAT

4.1 Vendi

Të gjitha pagesat e Garantuesit për një Përfitues sipas kësaj Garancie Sovrane i bëhen Përfituesit që bën kërkesën, në llogarinë bankare të Përfituesit që tregohet në kërkesë.

4.2 Monedha

Çdo shumë e pagueshme nga Garantuesi sipas kësaj Garancie Sovrane kundrejt VUB-it bëhet në euro. Çdo shumë e pagueshme nga Garantuesi sipas kësaj Garancie Sovrane kundrejt ISBA-së bëhet në ALL. Garantuesi heq dorë nga çdo e drejtë që mund të ketë në një juridiksion për të paguar një shumë në një monedhë të ndryshme nga ajo që është parashikuar të jetë e pagueshme.

4.3 Kompensimi dhe kundërpretendimi

Të gjitha pagesat e bëra nga Garantuesi sipas kësaj Garancie Sovrane bëhen pa kompensim ose kundërpretendim.

4.4 Ditët pushim

Nëse një pagesë sipas kësaj Garancie Sovrane bëhet e kërkueshme në një ditë që nuk është Ditë Pune, data e kërkueshme për atë pagesë është dita pasuese e Punës në të njëjtin muaj kalendarik (sipas rastit) ose Dita pararendëse e Punës (sipas rastit).

4.5 Përfshirja e taksave

Të gjitha pagesat nga Garantuesi sipas kësaj Garancie Sovrane bëhen pa zbritje dhe të lira, si dhe pa bërë zbritje për llogari të ndonjë tatimi, përveç se në masën që Garantuesit i kërkohet ligjërisht të bëjë pagesat duke iu nënshtruar një tatimi. Nëse duhet të bëhet zbritje për një tatim ose shuma në lidhje me një tatim ose zbritje të tjera nga çdo shumë e pagueshme ose që paguhet nga Garantuesi sipas kësaj Garancie Sovrane, Garantuesi i paguan këto shuma shtesë që mund të jenë të nevojshme për të siguruar që Përfituesi përkatës merr një shumë neto të barabartë me shumën e plotë që do të kishte marrë nëse pagesa nuk do t'i nënshtrohej tatimit.

4.6 Dëftesat tatimore

Të gjitha tatimet që kërkohen me ligj të zbriten ose mbahen nga Garantuesi nga çdo shumë e paguar ose e pagueshme sipas kësaj Garancie Sovrane paguhet nga Garantuesi kur bëhen të kërkueshme dhe Garantuesi, brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga kryerja e pagesës, i paraqet përfituesit përkatës prova të pranueshme për Përfituesin (duke përfshirë dëftesat përkatëse tatimore) që pagesa është dërguar rregullisht tek autoriteti i duhur.

4.7 Shumat e destinuara

Në rastin e një pagese të pjesshme, Përfituesi mund ta alokojë këtë pagesë për llogari të detyrimeve të Garantuesit që mund të vendosë Përfituesi përkatës. Ky alokim mbizotëron mbi çdo alokim të bërë nga Garantuesi.

4.8 Interesi

Nëse Garantuesi nuk paguan një shumë të pagueshme prej tij VUB-it sipas kësaj Garancie Sovrane në ditën e kërkueshme, interesi mblidhet mbi shumën e prapambetur nga data e kërkueshme deri në datën e pagesës faktike (si para edhe pas vendimit) me një normë të barabartë me 1 muaj EURIBOR (që është norma në përqindje e zbatueshme e përcaktuar nga Federata Bankare e Bashkimit Europian, e treguar në faqen EURIBOR 01 të pasqyrës së Reutersit) plus 2% në vit e llogaritur duke iu referuar shumës së papaguar në periudhën e vonesës.

Nëse Garantuesi nuk paguan një shumë të pagueshme prej tij ISBA-së sipas kësaj Garancie Sovrane në ditën e kërkueshme, interesi mblidhet mbi shumën e prapambetur nga data e kërkueshme deri në datën e pagesës faktike (si para edhe pas vendimit) me një normë (interes vjetor plus kushtin penal) që tregohet në Marrëveshjen e Huas.

Çdo interes i mbledhur sipas kësaj klauzole është i pagueshëm menjëherë nga Garantuesi me kërkesë nga përfituesi përkatës.

4.9 Detyrimi i pullës dhe tatimi i vlerës së shtuar

4.9.1 Garantuesi zhdëmton Përfituesit në lidhje me çdo kosto, humbje ose detyrim që Përfituesi shkakton në lidhje me detyrimin e pullës, regjistrimin ose tatime të tjera të ngjashme në lidhje me një Dokument Financiar.

4.9.2 E gjithë shuma e pagueshme sipas një Dokumenti Financiar konsiderohet të jetë përjashtuar nga tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH). Nëse duhet të paguhet TVSH-ë, Garantuesi i paguan Përfituesit (përveç dhe në të njëjtën kohë kur paguan shumën) një shumë të barabartë me shumën e TVSH-së të pagueshme nga ky Përfitues. Garantuesi në të njëjtën kohë paguan gjithashtu dhe zhdëmton një Përfitues ndaj të gjithë TVSH-së së pësuar nga ai Përfitues në lidhje me koston ose shpenzimet e tij në lidhje me Dokumentet Financiare.

5. PËRFAQËSIMET DHE GARANCITË

Huamarrësi përfaqëson dhe i garanton çdo Përfituesi që:

5.1 Kompetencat dhe Autoriteti

Garantuesi ka kompetencën të japë dhe përmbushë këtë Garanci Sovrane dhe transaksionet e parashikuara në të dhe ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të autorizuar dhënien dhe përmbushjen e kësaj Garancie Sovrane dhe transaksionet e parashikuara këtu (duke përfshirë çdo të dhe të gjitha procedurat administrative që kërkohen për dhënien e kësaj Garancie Sovrane ose përmbushjen e çdo detyrimi të përcaktuar në të).

5.2 Vlefshmëria ligjore

Kjo Garanci Sovrane përbën një detyrim ligjor, të vlefshëm dhe detyrues të Garantuesit të ekzekutueshëm në pajtim me termat e saj dhe do të trajtohej e tillë në gjykatat e Anglisë dhe të Republikës së Shqipërisë. Kjo Garanci Sovrane është në formën e duhur për ekzekutimin e saj në të gjitha këto gjykata.

5.3 Mungesa e konfliktimit me ligjet

Përfundimi dhe përmbushja e kësaj Garancie Sovrane dhe transaksionet e parashikuara këtu janë dhe nuk do të jenë në konflikt me: i) asnjë ligj ose rregullore (duke përfshirë ligjet për buxhetin e shtetit të Republikës së Shqipërisë) ose një urdhër zyrtar ose gjyqësor; ose ii) kushtetutën e Garantuesit; ose iii) ndonjë marrëveshje ose dokument ku Garantuesi është palë ose që është detyruese për të ose ndonjë prej sendeve të tij pasurore, dhe nuk rezulton në krijimin ose vendosjen e një mjeti sigurie mbi ndonjë prej sendeve të tyre përkatëse pasurore në pajtim me dispozitat e një marrëveshjeje ose dokumenti të tillë.

5.4 Mosqenia në vonesë

Nuk ka ndodhur asnjë ngjarje që përbën qenie në vonesë sipas ose në lidhje me një marrëveshje ose dokument ku Garantuesi ose një Subjekt Publik është palë ose nëpërmjet të cilit Garantuesi ose një Subjekt Publik mund të detyrohet dhe nuk ka ndodhur asnjë ngjarje, e cila me bërjen e njoftimit, parashkrimit, përcaktimit të rëndësisë ose një kusht tjetër mund të pritet në mënyrë të arsyeshme të përbëjë qenie në vonesë sipas ose në lidhje me një marrëveshje ose dokument të tillë në çdo rast, në një masë ose në një mënyrë që mund të kishte efekt negativ të konsiderueshëm për Garantuesin ose Subjektin Publik ose aftësinë e Garantuesit për të përmbushur detyrimet e tij.

5.5 Pëlqimet

Të gjitha autorizimet, aprovimet, pëlqimet, licencat, përjashtimet, depozitimet, regjistrimet, noterizimet dhe çështjet e tjera, zyrtare ose jo, që kërkohen ose janë të kështillueshme në Republikën e Shqipërisë në lidhje me lidhjen, përmbushjen, vlefshmërinë ose ekzekutueshmërinë e kësaj Garancie Sovrane dhe transaksionet e parashikuara në të janë marrë ose realizuar dhe janë në fuqi të plotë.

5.6 Gjykimi

Asnjë gjykim, arbitrazh ose procedim administrativ nuk është faktik, në vazhdim ose i mundshëm, që mund të pritej në mënyrë të arsyeshme të vinte në rrezik vlefshmërinë ose përmbushjen e detyrimeve të Garantuesit.

5.7 Mungesa e imunitetit

5.7.1 Garantuesi i nënshtrohet ligjit civil në lidhje me detyrimet e tij sipas kësaj Garancie Sovrane.

5.7.2 Hyrja në fuqi dhe përmbushja e kësaj Garancie Sovrane përbën veprim juridik privat dhe tregtar.

5.7.3 As Garantuesi dhe as sendet e tij pasurore nuk gëzojnë të drejtën e imunitetit nga kompensimi, padia ose ekzekutimi në lidhje me detyrimet e tij sipas kësaj Garancie Sovrane.

5.8 Tatimet mbi pagesat

Shumat e pagueshme nga Garantuesi mund të bëhen të lira dhe pa zbritje të ose për llogari të taksave.

5.9 Detyrimet e pullës

Asnjë detyrim pulle ose regjistrimi ose tatim apo detyrim i ngjashëm nuk është i pagueshëm në Mbretërinë e Bashkuar ose Republikën e Shqipërisë në lidhje me këtë Garanci Sovrane.

5.10 Renditja *pari passu*

Detyrimet e Garantuesit të parashikuara këtu renditen të paktën *pari passu* me të gjitha detyrimet e tij të tjera të tashme dhe të ardhshme, të pasiguruara dhe jodytësore, përveç detyrimeve që preferohen në mënyrë të detyrueshme më ligj dhe jo në bazë të marrëveshjes.

5.11 Ekzekutimi i vendimeve

Një vendimi dhënë në një gjykatë angleze kundër Garantuesit duhet të jetë i ekzekutueshëm ndaj Garantuesit në Republikën e Shqipërisë sipas Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë të zbatueshëm në momentin e ekzekutimit. Sipas Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, zbatimi i njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të huaja në Republikën e Shqipërisë paraqitet për vendim në një gjykatë rrethi (qyteti). Vendimi i një gjykate të huaj pas njohjes së tij në Republikën e Shqipërisë ekzekutohet në pajtim me procedurat e specifikuara në Kodin e Procedurës Civil të Republikës së Shqipërisë.

5.12 Informacioni

5.12.1 Çdo informacion i dhënë nga ose në emër të Garantuesit një Përfituesi ka qenë i vërtetë dhe i saktë në të gjitha aspektet e rëndësishme në datën që është dhënë ose në datën (sipas rastit) në të cilën deklarohet.

5.12.2 Nuk ka ndodhur asgjë dhe nuk është lënë asgjë pa dhënë nga informacioni i parashikuar dhe referuar në klauzolën 5.12.1 dhe nuk është dhënë ose mbajtur informacion i tillë që rezulton në faktin që ky informacion të jetë jo i vërtetë ose keqorientues në një aspekt të konsiderueshëm.

5.12.3 Garantuesi konfirmon dhe njeh që është i ndërgjegjshëm dhe ka njohuri për termat dhe kushtet e Garancisë bankare, Marrëveshjen për Lëshimin e Garancisë Bankare, marrëveshjen e huas dhe Marrëveshjen e Pajtimit.

5.13 Përsëritja

Përfaqësimet dhe garancitë e parashikuara në këtë klauzolë 5 i mbijetojnë ekzekutimit të kësaj Garancie Sovrane dhe konsiderohen të përsëriten në datën e çdo kërkese referuar fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë në atë moment, sikur të bëheshin në çdo rast të tillë.

6. DETYRIMET

Detyrimet në këtë klauzolë 6 mbeten në fuqi nga dhe pas datës së tyre dhe për sa kohë që një shumë e tillë është ose mund të jetë e pashlyer sipas kësaj ose një dokumenti financiar në fuqi.

6.1 Informacioni

Garantuesi u paraqet Përfituesve, në kopje të mjaftueshme, menjëherë kopje për secilin prej Përfituesve, çdo informacion në lidhje me gjendjen financiare të Garantuesit ose një Subjekti Publik që Përfituesi mund të kërkojë.

6.2 Njoftimi i qenies në vonesë

Garantuesi njofton Përfituesit me shkrim për çdo ngjarje të referuar në klauzolën 3 menjëherë pas ndodhjes së saj.

6.3 Certifikatat e përputhshmërisë

Garantuesi, menjëherë me kërkesë të arsyeshme të Përfituesve herë pas here u paraqet Përfituesve certifikata të Garantuesit që certifikojnë që nuk ka ndodhur dhe nuk po vazhdon asnjë ngjarje e referuar në klauzolën 3 ose, nëse kjo ka ndodhur, specifikon ngjarjen dhe hapat që merren për të korrigjuar atë.

6.4 Pëlqimet

Garantuesi merr dhe rinovon menjëherë herë pas here dhe u paraqet kopje të certifikuara Përfituesve të atyre autorizimeve, aprovimeve, pëlqimeve, licencave dhe përjashtimeve që mund të kërkohet sipas një ligji ose rregulloreje të zbatueshme për t'i mundësuar atij përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kësaj Garancie Sovrane ose që kërkohet për vlefshmërinë ose ekzekutueshmërinë e kësaj Garancie Sovrane dhe Garantuesi i respekton termat e saj.

6.5 Renditja Pari Passu

Detyrimet e Garantuesit të parashikuara këtu renditen të paktën *pari passu* me të gjitha detyrimet e tjera të pasiguruara të Garantuesit, përveç detyrimeve që preferohen në mënyrë të detyrueshme me ligj dhe jo në bazë të marrëveshjes.

6.6 Pengu negativ

Garantuesi nuk jep ose lejon dhe merr masa që asnjë Subjekt Publik të mos japë ose lejojë tjetërsimin e një mjeti sigurimi mbi ndonjë prej

sendeve të tij pasurore ose të ardhurave të tashme ose të ardhshme ose mbi rezervat e jashtme zyrtare të Republikës së Shqipërisë (kjo shprehje përfshin arin dhe rezervat e Republikës së Shqipërisë tek cilido dhe në çfarëdo forme në pronësi ose posedim ose që rregullisht konsiderohet dhe mbahet si rezervë e jashtme zyrtare) ose një pjesë të tij për të garantuar një gjendje borxhi financiar të Garantuesit, përveç kur Garantuesi, në rastin e dhënies së Garancisë, para ose në të njëjtën kohë, dhe ne çdo rast, menjëherë merr masa që të gjitha shumat e pagueshme në lidhje me Dokumentin Financiar të sigurohen në mënyrë të barabartë dhe proporcionale, ose një garanci tjetër ose masë tjetër që aprovohet nga Përfituesit.

6.7 Kushtet

Garantuesi duhet t'u ketë dhënë Përfituesve në ose para datës së kësaj Garancie Sovrane në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Përfituesit:

a) prova nga Ministri i Financave që kjo Garanci Sovrane nuk është në shkelje të ligjit nr. 185/2013, datë 28 dhjetor 2013 "Mbi buxhetin e vitit 2014" të Republikës së Shqipërisë, si dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Mbi menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

b) një ekzemplar të nënshkrimit të Ministrit të Financave;

c) prova të autoritetit të Ministrit të Financave për të nënshkruar këtë Garanci Sovrane dhe për të detyruar Republikën e Shqipërisë;

d) prova që Republika e Shqipërisë nuk është përfshirë në asnjë gjykim civil ose arbitrazhi në lidhje me pretendimet ose shumat që janë të konsiderueshme në kontekstin e Garancisë Sovrane dhe nuk është në dijeni të ndonjë gjykimi civil ose arbitrazhi të mundshëm në lidhje me këto pretendime ose shuma;

e) prova që agjenti i procesit i përmendur në klauzolën 13.4 ka pranuar emërimin e tij;

f) mendimin e Ministrit të Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë në lidhje me Dokumentet financiare dhe këtë Garanci Sovrane thelbësisht në formën e përcaktuar në grafikun 2 më poshtë.

7. AMENDIMET DHE HEQJET DORË

7.1 Procedura

7.1.1 Çdo term i kësaj Garancie sovrane mund të ndryshohet ose hiqet dorë vetëm me pëlqimin e përfituesve dhe të Garantuesit, duke përfshirë, ndër të tjera, termat në lidhje me:

a) shtyrjen e datës ose rritjen e shumës ose një ndryshim në monedhë, një pagesë sipas kësaj Garancie Sovrane; ose

b) afatin e kësaj Garancie Sovrane.

7.2 Mjetet mbrojtëse shtuese

7.2.1 Të drejtat e Përfituesve sipas kësaj Garancie Sovrane:

a) mund të ushtrohen aq shpesh sa të jetë e nevojshme;

b)janë shtuese dhe nuk përjashtojnë të drejtat sipas ligjit të përgjithshëm; dhe

c) prej tyre mund të hiqet dorë vetëm me shkrim dhe në mënyrë specifike.

7.2.2 Çdo vonese nga një Përfitues në ushtrimin ose mosushtrimin e një të drejte të përcaktuar në klauzolën 7.2.1 nuk është heqje dorë nga kjo e drejtë.

8. NJOFTIMET

8.1 Bërja e njoftimeve

8.1.1 Të gjitha njoftimet dhe komunikimet e tjera sipas ose në lidhje me këtë Garanci Sovrane bëhen me shkrim dhe dorëzohen dorazi, me korrier ndërkombëtar ose postë të klasës së parë të parapaguar. Çdo njoftim i tillë konsiderohet të jetë kryer si më poshtë:

a) nëse dorëzohet dorazi, në momentin që lihet në adresën përkatëse me konfirmim marrje;

b) nëse dorëzohet me korrier ndërkombëtar, në ditën e konfirmuar nga shërbimi i korrierit ndërkombëtar si dita ku është marrë nga marrësi; dhe

c) nëse postohet me postë të parapaguar të klasës së parë, në ditën e konfirmuar nga dhënësi i shërbimit postar si dita kur është marrë nga marrësi.

8.1.2 Megjithatë, një njoftim i bërë në pajtim me sa më sipër, por i marrë në një ditë jopune ose pas orarit zyrtar në vendim e marrjes konsiderohet të jetë dhënë në ditën pasuese të punës në atë vend.

8.2 Adresat për njoftimet

8.2.1 Adresa e secilës prej këtyre Palëve për të gjitha njoftimet sipas ose në lidhje me këtë Garanci Sovrane, janë:

a) ato të njoftuara nga kjo Palë për këtë qëllim Palës tjetër në ose para datës së bëhet Palë; ose

b) çdo adresë tjetër të njoftuar nga ajo Palë

për këtë qëllim Palës tjetër, me jo më pak se një afat prej pesë Ditë Pune.

8.2.2 Adresat e Palëve janë:

a) për Garantuesin:

Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë, bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë, Republika e Shqipërisë.

Faks: _____

Në vëmendje të: _____

b) për VUB-in:

Všeobecná úverová banka, a.s. Mlynské nivy 1, Bratislava, Postal Code: 829 90, Slovak Republic

Faks: _____

Në vëmendje të: _____

c) për ISBA-në:

Rr. "Ismail Qemali", nr. 27, Tiranë, Republika e Shqipërisë

Faks: 00355 4 2248 762

Në vëmendje të: Silvio Pedrazzi

9. TRANSFERIMET

9.1 Pasuesit

Kjo Garanci Sovrane është detyruese dhe në përfitim të Garantuesit dhe Përfituesve dhe pasuesve dhe cesionarëve të tyre përkatës.

9.2 Transferimet nga Garantuesi

Garantuesi nuk mund të kalojë ose të transferojë të gjitha ose një pjesë të të drejtave dhe detyrimeve pa pëlqimin e mëparshëm me shkrim të të gjithë Përfituesve.

9.3 Transferimet nga Përfituesit

Çdo Përfitues në çdo kohë mund të kalojë ose ndryshe transferojë të gjitha ose një pjesë të të drejtave të tij nëse ky Përfitues kalon ose ndryshe transferon të gjithë ose një pjesë të barasvlershme të të drejtave të tij sipas Dokumentit Financiar. Garantuesi i nënshtrohet çdo kalimi, transferimi ose rinovimi nga një Përfitues.

9.4 Deklarimi

Çdo Përfitues mund t'i deklarojë një cesionari, pasuesi ose personi tjetër që propozon lidhjen e një kontrate me këtë Përfitues në lidhje me Dokumentin Financiar përkatës ose këtë Garanci Sovrane çdo informacion që është në zotërim të këtij Përfituesi në lidhje me Garantuesin ose subjektet e tij përkatëse që e konsideron të përshtatshme.

10. KOMPENSIMI

Çdo Përfitues mund (por nuk është i detyruar) të kompensojë çdo detyrim të Garantuesit që është i kërkueshëm dhe i pagueshëm me çdo fond që zotërohet nga ky Përfitues për llogari të Garantuesit në çdo zyrë të këtij Përfituesi, kudo dhe në çdo monedhë. Ky Përfitues mund të kryejë ato shkëmbime monetare që janë të përshtatshme për të zbatuar kompensimin.

11. GJUHA

Çdo dokument i përmendur këto ose që dorëzohet është në gjuhën angleze.

12. KOSTO DHE SHPENZIME

Garantuesi me kërkesë rimburson Përfituesit për shumën e të gjitha kostove, shpenzimeve, humbjeve dhe/ose detyrimeve (duke përfshirë, pa kufizim, tarifat ligjore dhe çdo TVSH-je) që pësohen prej tyre në lidhje me ekzekutimin dhe zbatimin e kësaj Garancie Sovrane, si dhe ruajtjen e të drejtave të Përfituesve sipas kësaj Garancie Sovrane dhe/ose hetimin e nga Përfituesit e çdo shkeljeje të mundshme të kësaj Garancie Sovrane.

13. LIGJI I ZBATUESHËM, JURIDIKSIONI DHE EKZEKUTIMI

13.1 Ligji i zbatuar

Kjo Garanci Sovrane rregullohet nga ligjet e Anglisë, duke përfshirë interpretimin, vlefshmërinë, përmbushjen, ekzekutimin dhe prishjen e saj dhe çdo detyrim jashtëkontraktual që rrjedh prej saj ose në lidhje me të.

13.2 Juridiksioni

Garantuesi bie dakord në interes të Përfituesve që gjykatat e Anglisë të kenë juridiksion për të gjykuar dhe vendosur për çdo padi ose procedim dhe të zgjidhin çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga ose në lidhje me këtë Garanci Sovrane dhe, për këtë qëllim, i nënshtrohet në mënyrë të pakthyeshme juridiksionit të gjykatave angleze.

13.3 Forumi i përshtatshëm

Garantuesi në mënyrë të pakthyeshme heq dorë nga çdo kundërshtim që mund të ketë tani ose më vonë për caktimin e gjykatave të Anglisë si forumi për të gjykuar dhe vendosur në çdo gjykim dhe të zgjidhin çdo mosmarrëveshje dhe bie dakord për të mos pretenduar që ndonjë prej këtyre gjykatave nuk është forumi i përshtatshëm ose i duhur.

13.4 Njoftimi i padisë

Garantuesi në mënyrë të pakthyeshme emëron Ambasadorin e Republikës së Shqipërisë

me adresë 22 St. George' Drive, London SW1V 4DG, si agjentin e atij të autorizuar për njoftimin e padisë në Angli në lidhje me çdo gjykim ose mosmarrëveshje. Asgjë në këtë klauzolë 13.4 nuk ndikon të drejtën e një Përfituesi për të njoftuar padinë në një mënyrë tjetër të lejuar me ligj.

13.5 Mungesa e ekskluzivitetit

Nënshtrimi ndaj juridiksionit të gjykatave të Anglisë nuk kufizon (dhe nuk interpretohet si i tillë) të drejtën e një Përfituesi të fillojë gjykimin në një gjykatë tjetër me juridiksion kompetent, dhe as nisja e gjykimin në një ose më shumë juridiksione nuk përjashton fillimin e gjykimit në një juridiksion tjetër (qoftë njëherazi ose jo), nëse dhe në masën e lejuar nga ligji.

13.6 Pëlqimi për ekzekutimin

Garantuesi përgjithësisht jep pëlqimin në lidhje me çdo procedim për dhënien e mbrojtjes ose lëshimin e një urdhri në lidhje me një procedim të tillë duke përfshirë (pa kufizim) nxjerrjen, zbatimin ose ekzekutimin e detyruar ndaj çdo prone (pavarësisht nga përdorimi ose përdorimi i destinuar i saj) të çdo urdhri apo vendimi gjyqësor që mund të nxirret ose jepet për këtë procedim.

13.7 Heqja dorë nga imuniteti

Në masën që Garantuesi mund të pretendojë imunitet në një juridiksion për vete ose sendet pasurore ose të ardhurat e tij ndaj padisë, ekzekutimit, sekuestros (qoftë në mbështetje të ekzekutimit, para vendimit ose ndryshe dhe bazuar në shkaqe sovraniteti ose jo) ose ndaj masave të tjera ligjore dhe në masën që ky imunitet (i pretenduar ose jo) mund t'i vishet në një juridiksion të tillë Garantuesit ose sendeve ose të ardhurave të tij, Garantuesi bie dakord për të mos pretenduar dhe heq dorë në mënyrë të pakthyeshme nga ky imunitet në masën e plotë të lejuar nga ligjet e këtij juridiksioni, megjithatë, me kusht që nga imuniteti të mos hiqet dorë në lidhje me "mjediset e tashme ose të ardhme të misionit" sipas përkufizimit të Konventës së Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplomatike të nënshkruar në vitin 1961, "mjediset konsullore" sipas përkufizimit në Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore të nënshkruara në vitin 1963 ose pronën me karakter ushtarak ose sendet pasurore ushtarake ose pronën apo sendet pasurore të Garantuesit në lidhje me to.

14. NDASHMËRIA

Nëse një dispozitë e kësaj Garancie sovrane ndalohet ose është e pazbatueshme në një juridiksion, ky ndalim ose mosekzekutueshmëri nuk zhvleftëson dispozitat e mbetura dhe nuk cenon vlefshmërinë ose ekzekutueshmërinë e kësaj dispozite në një juridiksion tjetër.

15. AFATI

Kjo Garanci Sovrane hyn në fuqi pas nënshkrimit të saj të rregullt si dokument nga të gjitha Palët dhe mbetet në fuqi të plotë deri sa të jenë paguar dhe shlyer plotësisht të gjitha shumat e kërkueshme dhe të pagueshme sipas Dokumenteve Financiare.

Nënshrkuar si Dokument nga Republika e Shqipërisë e përfaqësuar nga Ministri i Financave që vepron me autoritetin e Republikës së Shqipërisë në pajtim me ligjet e Republikës së Shqipërisë:

_____

(emri)

(pozicioni)
(datë)

Nënshkruar si dokument nga Všeobecná úverová banka, a.s., e përfaqësuar nga personat e përmendur më poshtë, që veprojnë me autoritetin e kësaj shoqërie në pajtim me ligjet e territorit të themelimit të saj:

_____

(Vincenzo Petraroli

Përfaqësues me prokurë të datës 29.7.2014 (bashkëngjitur kësaj Garancie Sovrane dhe Zhdëmtimi)

_____

Nënshkruar si dokument nga Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a., e përfaqësuar nga personat e përmendur më poshtë, që veprojnë me autoritetin e kësaj shoqërie në pajtim me ligjet e territorit të themelimit të saj:

_____

Silvio Pedrazzi

Drejtor i përgjithshëm

_____

GRAFIKU 1
FORMULARI I KËRKESËS

Drejtuar: Republikës së Shqipërisë
Ministrisë së Financave
Në vëmendje të: _____

(datë)
I dashur Zotëri,

Ne i referohemi Garancisë Sovrane dhe Dokumentit të Zhdëmtimit, të nënshkruar ndërmjet Republikës së Shqipërisë, si Garantues, dhe Všeobecná úverová banka, a.s., dhe Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a., si Përfitues, më _____ 2014 ("Garancia Sovrane").

Termat e përkufizuar në Garancinë Sovrane kanë të njëjtat kuptime që përdoren në këtë kërkesë.

1. Ne vërtetojmë që (VUB-it i është kërkuar më _____ t'i paguajë EUR _____ CEZ-it sipas Garancisë Bankare ("Shuma e Kërkueshme") ose (OSHEE sh.a. duhet të ketë paguar shumën e _____ ("Shuma e Kërkuar") më _____ sipas (Dokumentit Financiar) dhe nuk ka paguar shumën e kërkuar në shkelje të (Dokumentit Financiar). Shuma e kërkuar është në lidhje me (Garancinë Bankare / Marrëveshjen për Lëshimin e Garancisë Bankare / Marrëveshjen e Huas) dhe përkatësisht është një Shumë e Garantuar. Kështu ne kërkojmë pagesën nga Garantuesi të shumës prej _____.

2. Pagesa duhet të bëhet në adresën e mëposhtme:
Banka:
Numri i llogarisë:
Kodi Swift::

3. Pagesa sipas kësaj kërkese bëhet menjëherë pas marrjes së saj dhe në asnjë rast më vonë se tri (3) Ditë Pune nga data e marrjes së kësaj kërkese.

Sinqerisht i Juaji,
(Všeobecná úverová banka, a.s. / Intesa Sanpaolo Bank Albania Sh.A.)

GRAFIKU 2
FORMULARI I MENDIMIT LIGJOR

(Koka zyrtare e letrës së Ministrisë së Drejtësisë)

Drejtuar: (Všeobecná úverová banka, a.s. / Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a.)
Në vëmendje të: _____

(Datë)

Të dashur Zotërinj,

Lënda: Mendimi ligjor mbi Garancinë Sovrane dhe Dokumentin e Zhdëmtimit, të nënshkruar ndërmjet Republikës së Shqipërisë, si Garantues, dhe Všeobecná úverová banka, a.s. dhe Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a., si Përfitues, më _____ 2014;

Ne i referohemi Garancisë Sovrane dhe Dokumentit të Zhdëmtimit, të nënshkruar ndërmjet Republikës së Shqipërisë, si Garantues, dhe Všeobecná úverová banka, a.s. dhe Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a. (ISBA) si Përfitues më _____ 2014 "Garancia Sovrane"). Termat e përkufizuar në Garancinë Sovrane kanë të njëjtat kuptime që përdoren në këtë mendim ("Mendimi ligjor").

Më _____2014, VUB-i dhe OSHEE sh.a. lidhën Marrëveshjen për Lëshimin e Garancisë Bankare sipas së cilës VUB-i ra dakord të lëshojë Garancinë Bankare dhe OSHEE sh.a. mori përsipër t'i paguajë VUB-it Koston e Garancisë Bankare dhe, nëse ekzekutohet Garancia Bankare, Shumën e Garancisë Bankare. Më _____ 2014, VUB-i, në cilësinë e tij si garantues, dhe CEZ-i, në cilësinë e tij si përfitues, nënshkruan Garancinë Bankare, bazuar në të cilën VUB-i mori përsipër të garantojë pagesat që duhet të bëhen nga OSHEE sh.a. sipas Marrëveshjes së pajtimit me CEZ-in. Më _____ 2014, OSHEE sh.a. dhe ISBA-ja lidhën Marrëveshjen e Huas sipas së cilës ISBA-ja mori përsipër t'i japë OSHEE sh.a. një kredi debitore sipas termave të Marrëveshjes së Huas.

Në lidhje me Garancinë Bankare, detyrimet e OSHEE sh.a. sipas Marrëveshjes për Lëshimin e Garancisë Bankare dhe Marrëveshjes së Huas, Republika e Shqipërisë ("Shteti") dhe Përfituesit lidhën Garancinë Sovrane nëpërmjet së cilës Shteti rigarantonte detyrimet e VUB-it sipas Garancisë Bankare dhe garantonte detyrimet e OSHEE sh.a. sipas Marrëveshjes për lëshimin e Garancisë Bankare dhe Marrëveshjes së Huas në favor të Përfituesve.

Në cilësinë time si Ministër i Drejtësisë i Republikës së Shqipërisë, unë kam këqyrur kopjen e nënshkruar të secilës prej Garancisë Bankare, Marrëveshjes për Lëshimin e Garancisë Bankare, Marrëveshjes së Huas dhe Garancisë Sovrane, si dhe të gjithë dokumentacionin tjetër, kam shqyrtuar Kushtetutën e Shqipërisë së bashku me ligjet, rregulloret, dokumentet dhe të tjera dhe kam bërë hetime të tjera që i konsideroj të nevojshme dhe të përshtatshme për qëllimet e dhënies së këtij mendimi. Bazuar në sa më sipër, unë jam i mendimit dhe deklaroj përkatësisht që:

a) (Nëpërmjet (vendosni referencën tek autorizimi i Qeverisë (ose të një personi apo organi tjetër) të dhënë për përfaqësuesin të negociojë dhe të nënshkruajë Garancinë Sovrane në emër të Republikës së Shqipërisë), Presidenca (ose një person apo organ tjetër të autorizuar) autorizon _____, Ministrin e (Financave), të lidhë dhe të nënshkruajë Garancinë Sovrane në emër të Shtetit. Autorizimi i dhënë _____ për të ndërmarrë këto veprime në emër të Shtetit, vazhdon të mbetet në fuqi të plotë në momentin e nënshkrimit të këtyre marrëveshjeve të sipërpërmendura.

b) Pas shqyrtimit të projekteve të negociuara të Garancisë Bankare, Marrëveshjes për Lëshimin e Garancisë Bankare, Marrëveshjes së Huas dhe Garancisë Bankare, Këshilli i Ministrave të Shqipërisë (ose një person ose organ tjetër i autorizuar) ka vendosur më _____ të aprovojë projektet e Marrëveshjes për Lëshimin e Garancisë Bankare, Marrëveshjes së Huas dhe Garancisë Sovrane.

c) Në pajtim me dispozitat e nenit 121 të Kushtetutës së Shtetit, negocimet dhe ratifikimet e traktateve i nënshtrohen vullnetit të Kuvendit Popullor të Shtetit.

d) Në pajtim me dispozitat e nenit 26 të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006 "Mbi huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë për huat shtetërore në Republikën e Shqipërisë", dhe neneve 117 dhe 121 të Kushtetutës së Shtetit, për negocimin, nënshkrimin, shpalljen dhe zbatimin e Marrëveshjes për Lëshimin e Garancisë Bankare, Marrëveshjes së Huas dhe lidhjen e Garancisë Sovrane është dhënë pëlqimi nga Parlamenti i Shqipërisë në pajtim me (citoni ligjin e miratuar nga Parlamenti që ka dhënë pëlqimin e ratifikimit të Marrëveshjes së Huas dhe Garancisë Sovrane).

e) Në pajtim me dispozitat e vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s (Subjekti Rregullator i Energjisë), Marrëveshja për Lëshimin e Garancisë Bankare, Marrëveshjen e Huas dhe Garancinë Sovrane janë ratifikuar nga Bordi i sipërpërmendur më 29.7.2014, i provuar me vendimin nr. 66 të dhënë nga ERE.

f) Në pajtim me dispozitat e ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006 "Mbi huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë për huat shtetërore në Republikën e Shqipërisë", kërkesa në lidhje me publikimin e njoftimit të nënshkrimit, shpalljes, ratifikimit dhe përmbushjes ose një aspekti tjetër të Marrëveshjes për Lëshimin e Garancisë Bankare, Marrëveshjes së Huas dhe Garancisë Sovrane është plotësuar dhe përmbushur.

g) Në pajtim me dispozitat e ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006 "Mbi huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë për huat shtetërore në Republikën e Shqipërisë", kërkesat në lidhje me nënshkrimin, shpalljen dhe përmbushjen e Garancisë Sovrane është plotësuar dhe përmbushur.

h) Të gjitha veprimet, kushtet dhe autorizimet që duhet të nënshkruhen, përmbushen dhe realizohen me qëllim që t'i mundësohet Shqipërisë, si Garantues, dhe OSHEE sh.a. të lidhë ligjërisht, ushtrojë të drejtat e saj dhe përmbushë detyrimet e parashikuara në Garancinë Sovrane, Marrëveshjen për Lëshimin e Garancisë Bankare dhe Marrëveshjen e Huas, përkatësisht, janë përmbushur dhe realizuar në përputhje të plotë me Kushtetutën dhe ligjet e Shqipërisë.

i) Detyrimet e Shtetit si Garantues dhe OSHEE sh.a. si Huamarrës, siç janë parashikuar në Garancinë Sovrane, Marrëveshjen për Lëshimin e Garancisë Bankare dhe Marrëveshjen e Huas, përkatësisht, përbëjnë detyrime ligjore, të vlefshme dhe detyruese të Garantuesit dhe OSHEE sh.a. dhe janë të ekzekutueshme në pajtim me termat e tyre përkatës.

j) Detyrimet e shtetit të parashikuara në Garancinë Sovrane përmbajnë detyrime ndërkombëtare të Shtetit dhe janë aprovuar në pajtim me dispozitat e Kushtetutës së Shtetit në lidhje me marrëveshjet ndërkombëtare.

k) Përfaqësimi dhe garancia e Shtetit sipas klauzolave 5.7, pëlqimi i shtetit sipas klauzolës 13.6 dhe heqja dorë nga Shteti sipas 13.6 të Garancisë Sovrane përbëjnë detyrime të ligjshme të vlefshme dhe detyruese për Shtetin dhe janë të ekzekutueshme ndaj Shtetit në pajtim me termat e tyre përkatës.

Së fundmi, jeni të lutur të vini re që Shteti ka miratuar një ligj që i jep Bankës privilegje, imunitete dhe përjashtime pasi Shqipëria është anëtare e Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Sinqerisht i Juaji
Ministri i Drejtësisë
Republika e Shqipërisë

MARRËVESHJE MBI LËSHIMIN E GARANCISË BANKARE NR. 35/ZF/2014

Datë 31 korrik 2014

ndërmjet Všeobecná úverová banka, a.s. Dhe Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (ish-CEZ Shpërndarje sh.a.).

Përmbledhje e termave kryesorë të Marrëveshjes

Tipi i financimit	Garancia	Periudha e Disponibilitetit:	3 muaj nga data e kësaj Marrëveshjeje
Limiti i Përgjithshëm i Financimit	EUR 86,000,000	Monedha e përdorimit	EUR
Tarifa e Përpunimit	0.15 % e Shumës së Garancisë për çdo vit	Tarifa e lëshimit të Garancisë:	1.0625 % e Shumës së Garancisë për çdo afat
Kolaterali:	Garancia Sovrane e Republikës së Shqipërisë		

Kjo marrëveshje garancie mbi lëshimin e garancisë bankare nr. 35/ZF/2014 (më poshtë "Marrëveshja") lidhet më 31 korrik 2014

Ndërmjet

1. Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (ish-CEZ Shpërndarje sh.a.), një shoqëri e themeluar në Shqipëri dhe e regjistruar në Regjistrin Tregtar që mbahet nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit me numrin unik të identifikimit (NUIS) K72410014H, selia e së cilës është te Rr. Andon Zako Çajupi, Pallati Conad, kati III, Tiranë, Republika e Shqipërisë (më poshtë "Huamarrësi");

2. Všeobecná úverová banka, a.s., me zyrë të regjistruar te Mlynské nivy 1, 829 90 Bratislava, Republika Sllovake, nr. identifikimi: 31 320 155, regjistruar në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit të Bratislavës 1, seksioni: Sa, hyrja nr.: 341/B (më poshtë "Huadhënësi").

Palët bien dakord si më poshtë:

1. INTERPRETIMI

Në këtë Marrëveshje termat me germën e parë kapitale kanë kuptimet e dhëna në grafikun 1.

Interpretimi i dispozitave të kësaj Marrëveshjeje rregullohet nga rregullat e përcaktuara në grafikun 1.

2. GARANCIA

a) Në pajtim me termat e kësaj Marrëveshjeje, Huadhënësi merr përsipër t'i japë Huamarrësit Garancinë.

b) Garancia konsiderohet të jetë dhënë në momentin kur në të janë nënshkrimet e përfaqësuesve të Huadhënësit dhe Përfituesit, pavarësisht faktit se kur hyn në fuqi. Për mënjanimin e çdo dyshimi Garancia e dhënë hyn në fuqi pas lëshimit të saj vetëm pasi të përmbushen të gjitha kushtet e saj për hyrjen në fuqi në pajtim me tekstin e saj.

3. QËLLIMI

Huamarrësi mund të kërkojë lëshimin e një garancie vetëm në lidhje me detyrimin e saj të pagesës që rrjedh nga Marrëveshja e Pajtimit.

4. PARAKUSHTET

4.1 Dokumentet e parakushteve

Huamarrësi nuk mund t'i paraqesë kërkesën Huadhënësit dhe Huadhënësi nuk është i detyruar të ofrojë për përdorim sipas angazhimit të përgjithshëm të financimit derisa Huamarrësi t'i ketë paparaqitur Huadhënësit të gjitha dokumentet dhe provat e specifikuara në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Huadhënësin.

4.2 Të tjera kushte paraprake

Huadhënësi duhet t'i ofrojë Huamarrësit çdo përdorim sipas Angazhimit të Përgjithshëm Financiar vetëm nëse, në datën e kërkesës dhe në datën e përdorimit:

i) të gjitha përfaqësimet sipas klauzolës (janë të vërteta dhe të sakta); dhe

ii) nuk ekziston asnjë Ngjarje e Qenies në Vonesë.

5. PËRDORIMI

a) Huamarrësi mund të kërkojë përdorimin vetëm pas kërkesës së mbushur rregullisht të dhënë Huadhënësit para përfundimit të Periudhës së Disponibilitetit.

b) Data e propozuar e Përdorimit duhet të jetë një datë që bie para përfundimit të Periudhës së Disponibilitetit dhe duhet të jetë një Ditë Pune.

c) Kërkesa duhet të nënshkruhet nga një person i autorizuar rregullisht për të vepruar në emër të Huamarrësit.

d) Përveç kur Huadhënësi bie dakord ndryshe, një kërkesë e paraqitur Huadhënësit është e parevokueshme.

e) Në një kërkesë Huamarrësi mund të kërkojë vetëm një përdorim.

f) Përveç kur Huadhënësi bie dakord ndryshe shprehimisht, momenti i fundit për marrjen nga Huadhënësi të kërkesës është ora 11:00 paradite, tri Ditë Pune para Datës së propozuar të Përdorimit.

g) Nëse janë përmbushur të gjitha kushtet e përcaktuara në këtë Marrëveshje, Huadhënësi duhet të lëshojë Garancinë brenda 1 (një) Dite Pune.

6. MONEDHA

Garancia jepet në monedhën euro.

7. PARAPAGESA DHE ANULIMI

7.1 Prishja automatikisht e Angazhimit për Garancinë

Angazhimi për Garancinë prishet automatikisht në fund të një Dite të zakonshme Pune të Huadhënësit, ku kjo ditë është dita e fundit e periudhës së Disponibilitetit.

7.2 Paligjshmëria

Huadhënësi duhet të njoftojë Huamarrësin menjëherë nëse vjen në dijeni që është ose do të jetë e paligjshme në një juridiksion të caktuar për Huadhënësin të përmbushë një prej detyrimeve të tij sipas Dokumenteve Financiare. Pas marrjes së një njoftimi të tillë ofrimi i Angazhimit të Garancisë ose pjesa përkatëse e tij konsiderohet të prishet automatikisht në datën e bërjes së njoftimit dhe si rezultat i tij Limiti i Garancisë ose pjesës përkatëse të tij anulohet menjëherë.

7.3 Ndryshimi i kontrollit

a) Huamarrësi duhet të njoftojë menjëherë Huadhënësin nëse vjen në dijeni që një person, grup personash, të ndryshëm nga personi, ose grup tjetër personash që kontrollojnë Huamarrësin në momentin e Marrëveshjes, kanë marrë ose suke vepruar bashkërisht kanë përftuar kontrollin mbi Huamarrësin.

b) Pasi njoftimi sipas paragrafit "a" të mësipërm t'i jetë bërë Huadhënësit ose nëse huadhënësi ndryshe vjen në dijeni që një person, grup personash, të ndryshëm nga personi, ose grup tjetër personash që kontrollojnë Huamarrësin në momentin e Marrëveshjes, kanë marrë ose suke vepruar bashkërisht kanë përftuar kontrollin mbi Huamarrësin, Huadhënësi, duke i bërë njoftim huamarrësit, mund të:

i) prishë Angazhimin e Garancisë ose një pjese të saj, si rezultat i së cilës Limiti i Garancisë ose një pjese të saj anulohet në datën e specifikuar nga huadhënësi në njoftim; dhe

ii) kërkojë Huamarrësit të ofrojë Mbulimin e Shpenzimeve në lidhje me Garancinë e dhënë.

c) Huadhënësi është i detyruar ndaj njoftimit të Huadhënësit sipas paragrafit "b" më sipër që nga data e dhënies së tij dhe duhet të përmbushë të gjitha kushtet dhe kërkesat e Huadhënësit të specifikuara në të.

d) Në paragrafët dhe më sipër:

"kontroll" është një situatë në të cilën një person është një person i kontrolluar i një personi tjetër ose personave të tjerë;

"duke vepruar bashkërisht" ka kuptimin e specifikuar në seksionin 66 b të Kodit Tregtar.

7.4 Të ndryshme

a) Asnjë pjesë e Limit të anuluar të Garancisë nuk mund të rinovohet në një datë të mëvonshme.

b) Për mënjanimin e dyshimit, as anulimi i Limitit të Garancisë dhe as prishja e Angazhimit të Garancisë ose një pjese të tij nuk rezulton në prishjen ose anulimin e Marrëveshjes.

8. PAGESA SIPAS GARANCISË

8.1 Pretendimet e përfituesit dhe detyrimet e Huamarrësit

a) Huamarrësi (si porositësi) kërkon në mënyrë të pakthyeshme dhe të pakushtëzuar që Huadhënësi të paguajë, pas një kërkese të parë të përfituesit, ku pretendimi i tij bëhet nën një Garanci që shfaqet si në përputhje me termat e Garancisë (vetëm në këtë klauzolë , pretendimi) sipas parashikimit në nenin 19 të Rregullave Uniforme të Garancive me kërkesë 758.

b) Huadhënësi është i detyruar të njoftojë Huamarrësin që përfituesi kërkon përmbushjen e pretendimit sipas Garancisë. Në ditën në të cilën Huadhënësi i paguan përfituesit shumën sipas Garancisë për të përmbushur pretendimin, Huamarrësi duhet t'i paguajë Huadhënësit menjëherë një shumë të barabartë me shumën e pretendimit (më poshtë në këtë klauzolë, shuma e kërkuar), përveç kur Huadhënësi dhe Huamarrësi bien dakord ndryshe.

c) Huamarrësi i njeh Huadhënësit që Huadhënësi:

i) nuk është i detyruar të kërkojë ndonjë pëlqim ose mendim nga ndonjë person (duke përfshirë Huamarrësin) para pagimit të një pretendimi të Përfituesit; dhe

ii) merr parasysh vetëm dokumentet e paraqitura Huadhënësit që kanë të bëjnë me Garancinë pa asnjë detyrim për të hetuar ose konsideruar raportin ligjor ndërmjet Huamarrësit dhe përfituesit dhe asnjë kundërshtim, kundërpretendim, veprim për ndonjë kompensim ose një veprim tjetër të bërë nga një person cilido qoftë.

d) Nëse përmbushen të gjitha dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshjeje, detyrimet e Huamarrësit ndaj Huadhënësit sipas kësaj klauzole janë të vlefshme dhe ekzistuese, pavarësisht nëse:

i) një dokument i paraqitur në lidhje me Garancinë konsiderohet të jetë i pavërtetë ose ligjërisht jo në fuqi;

ii) një kusht i përgjithshëm ose i veçantë në një dokument, i paraqitur në lidhje me Garancinë, nuk është përmbushur. Megjithatë, nëse kushti parashikohet në Garanci, Huadhënësi është i detyruar të kryejë shqyrtimin e nevojshëm sipas parashikimit në nenin 19 të Rregullave Uniforme të Garancive me kërkesë 758.

8.2 Dispozita të përgjithshme

Një Shumë Garancie konsiderohet të jetë shlyer ose parapaguar:

i) nëse Shuma e Garancisë është debituar me shumën e kësaj zbritjeje; ose

ii) plotësisht, nëse Huadhënësit i janë dhënë prova të pranueshme për Huadhënësin që ai nuk ka dhe nuk do të ketë detyrime të tjera sipas Garancisë.

9. INTERESI I MUNGUAR

Nëse Huamarrësi nuk paguan në kohë një shumë të pagueshme prej tij, sipas një Dokumenti Financiar, ai duhet t'i paguajë Huadhënësit interesin e munguar nga data e kërkueshme deri në datën e pagesës faktike.

10. TARIFA DHE SHPENZIME

10.1 Tarifa e përpunimit

a) Huamarrësi duhet t'i paguajë Huadhënësit një tarifë përpunimi për dhënien e Garancisë prej 0.15 për qind të Shumës së Garancisë, për çdo vit (duke përfshirë çdo afat vjetor që ka filluar).

b) Tarifa e përpunimit për Garancinë është e pagueshme paraprakisht në shumën e plotë për çdo periudhë njëvjeçare (duke përfshirë çdo periudhë njëvjeçare që ka filluar) ose për çdo periudhë kohore më të shkurtër që mbaron në datën e Skadencës së Garancisë. Për mënjanimin e dyshimit shuma e tarifës së përpunimit nuk zvogëlohet në asnjë rast nëse ajo paguhet për një periudhë më të shkurtër kohe se një periudhë njëvjeçare.

c) Tarifa e parë e përpunimit për Garancinë është e kërkueshme dhe e pagueshme jo më vonë se në datën e lëshimit të Garancisë dhe tarifat pasuese të përpunimit bëhen të kërkueshme dhe të pagueshme në intervale vjetore nga ajo datë maturimi e tarifës së parë të përpunimit. Tarifa e fundit e përpunimit është e kërkueshme dhe e pagueshme në datën e përvjetorit të fundit të Garancisë pas së cilës bie Data e Skadencës. Nëse data e kërkueshme e tarifës së përpunimit nuk bie në një Ditë Pune, tarifa është e pagueshme në Datën e Punës pararendëse.

10.2 Tarifa e Garancisë

a) Huamarrësi duhet t'i paguajë Huadhënësit një tarifë për dhënien e Garancisë prej 1.0625 për qind të Shumës së Garancisë, për çdo trimestër (duke përfshirë çdo trimestër që ka filluar). Afati për pagesën e tarifës fillon në datën e lëshimit të Garancisë dhe përfundon në Datën e Skadencës së tij.

b) Tarifa për Garancinë është e pagueshme paraprakisht në çdo trimestër (duke përfshirë çdo

trimestër që ka filluar) ose për çdo periudhë kohore më të shkurtër që mbaron në Datën e Skadencës së Garancisë përkatëse.

c) Tarifa për Garancinë është e kërkueshme dhe e pagueshme në datën e parë të trimestrit, për të cilin paguhet tarifa, dhe në rast se kjo ditë nuk është një Ditë Pune, tarifa është e pagueshme në Datën e Punës pararendëse.

10.3 Pagesa e tarifave - Garancia

Huadhënësi, të paktën 30 ditë kalendarike para datës së kërkueshme të çdo tarife sipas nënklauzolës dhe/ose nënklauzolës, informon Huamarrësin në lidhje me shumën e saktë të tarifës përkatëse dhe në lidhje me llogarinë e Huadhënësit ku duhet të paguhet tarifa përkatëse. Pasi Huamarrësi të marrë informacionin nga Huadhënësi sipas fjalisë së mësipërme, ai është i detyruar të bëjë pagesën përkatëse në pajtim me udhëzimin e Huadhënësin.

10.4 Kostot

Huamarrësi duhet të kompensojë Huadhënësin për çdo shumë (duke përfshirë koston e kështilltarëve ligjorë të Huadhënësit) që Huadhënësi ka pësuar ose mund të pësojë në lidhje me:

i) përgatitjen dhe nënshkrimin e një amendimi ose një ndryshim tjetër të një Dokumenti Financiar të kërkuar nga Huamarrësi;

ii) përgatitjen dhe nënshkrimin e një pëlqimi ose mendimi të kërkuar nga Huamarrësi nga Huadhënësi sipas një Dokumenti Financiar;

iii) ushtrimin dhe ruajtjen e një të drejte të Huadhënësit në pajtim me secilin prej Dokumenteve Financiare. Nuk paguhen shpenzime shtesë nga Huamarrësi në lidhje me detyrimin e Huadhënësit sipas seksionit.

10.5 Lista e çmimeve të Huadhënësit

a) Përveç kur kjo Marrëveshje parashikon ndryshe, Huamarrësi duhet t'i paguajë Huadhënësit të gjitha detyrimet dhe tarifat përkatëse sipas listës së çmimeve të Huadhënësit të zbatueshme në momentin kur paguhet kjo tarifë ose detyrim.

b) Tarifat dhe detyrimet përkatëse sipas listës së çmimeve të Huadhënësit në fuqi në momentin e kësaj Marrëveshjeje janë renditur në...

c) Çdo ndryshim në listën e çmimeve të Huadhënësit publikohet duke e shpallur në mjediset e punës së Huadhënësit dhe në faqen e internetit të Huadhënësit. Huamarrësi bie dakord shprehimisht që çdo ndryshim në listën e çmimeve të Huadhënësit është detyrues për të në masën e tij të plotë që nga data e hyrjes në fuqi të këtij ndryshimi.

11. PAGESAT

11.1 Vendi

Përveç kur një Dokument Financiar parashikon ndryshe, të gjitha pagesat nga çdo Palë sipas Dokumentit Financiar duhet të bëhen në llogari të Palës përkatëse, hollësitë e së cilës duhet t'i komunikohen Palës tjetër, të paktën pesë Ditë Pune para datës së kërkueshme të pagesës.

11.2 Data e maturimit që nuk bie në ditë pune

Përveç kur kjo Marrëveshje parashikon ndryshe, nëse një nga shumat e pagueshme sipas Dokumenteve Financiare bëhet e kërkueshme në një ditë që nuk është Ditë Pune, shuma bëhet e pagueshme në Ditën e Punës pasuese.

11.3 Fondet

Të gjitha pagesat nga Palët sipas Dokumenteve Financiare duhet të bëhen në llogarinë e Palës përkatëse në datën e kërkueshme për këtë pagesë.

11.4 Monedha

Përveç kur një Dokument Financiar specifikon ndryshe, monedha për pagesat sipas Dokumenteve Financiare përcaktohet si më poshtë:

i) pagesa e principalit duhet të bëhet në monedhën në të cilën është përcaktuar principali;

ii) pagesa e interesit duhet të bëhet në monedhën në të cilën shuma është përcaktuar shuma ku mblidhet interesi;

iii) rimbursimi i një shpenzimi duhet të bëhet në monedhën në të cilën është bërë shpenzimi;

iv) realizimi i mbulimit të shpenzimit ose kompensimit të pretendimit, që i paguhet përfituesit nga Huadhënësi në lidhje me një Garanci, duhet të bëhet në monedhën në të cilën është përcaktuar Shuma e Garancisë; dhe

v) çdo pagesë tjetër sipas Dokumentit Financiar duhet të bëhet në euro.

11.5 Dispozita të përgjithshme në lidhje me maturimin

Nëse Dokumenti Financiar nuk parashikon kohën se kur një pretendim bëhet i kërkueshëm dhe i pagueshëm, ky pretendim bëhet i pagueshëm brenda tri ditëve (3) Ditëve Pune nga

data në të cilën kërkesa e Palës së Autorizuar për pagesat i është dhënë Palës së Detyruar.

11.6 Kompensimi

a) Palët bien dakord që në masën e kërkueshme nga ligjet ekzistuese, e drejta e Huamarrësit për të kompensuar një prej pretendimeve të tij ndaj Huadhënësit për një pretendim të Huadhënësit sipas Dokumenteve Financiare përjashtohet.

b) Huadhënësi në çdo kohë mund të kompensojë pretendimin e tij ndaj Huamarrësit sipas Dokumentit Financiar për çdo pretendim (pavarësisht nëse pretendimi është i pagueshëm në momentin e kompensimit) të të njëjtin Huamarrës ndaj Huadhënësit. Nëse pretendimet që kompensohen përcaktohen në monedha të ndryshme, Huadhënësi ka të drejtën, për qëllimet e kompensimit, të konvertojë shumën e një pretendimi në monedhën e pretendimit tjetër, duke iu referuar Normës së Këmbimit në momentin e këtij konvertimi.

12. PËRFAQËSIME

12.1 Përfaqësime

Huamarrësi i konfirmon Huadhënësit që në datën e kësaj Marrëveshjeje secili prej përfaqësimeve të specifikuara në këtë klauzolë është i vërtetë dhe i saktë.

12.2 Statusi juridik

Huamarrësi është një shoqëri me kapital të përbashkët dhe i themeluar dhe ekziston ligjërisht sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë (vendi i themelimit) dhe është i licencuar rregullisht për të kryer aktivitetin siç po kryhet.

12.3 Autoriteti

a) Huamarrësi autorizohet të nënshkruajë çdo Dokument Financiar ku ajo është palë dhe të përmbushë të gjitha detyrimet sipas këtij Dokumenti Financiar.

b) Çdo Dokument Financiar ku Huamarrësi është palë është i vlefshëm dhe detyrues për të dhe i ekzekutueshëm ndaj tij. Nënshkrimi i çdo Dokumenti Financiar ku Huamarrësi është palë dhe përmbushja e detyrimeve sipas tij nuk është në kundërshtim me asnjë ligj, detyrim ose kufizim të cilit i nënshtrohet Huamarrësi.

12.4 Mungesa e ndryshimit negativ të konsiderueshëm

Në rastin e Huamarrësit, nuk ka pasur ndryshim të konsiderueshëm negativ në gjendjen financiare të Huamarrësit qysh nga data e kësaj Marrëveshjeje.

12.5 Gjykimi

Asnjë mosmarrëveshje ose procedim (duke përfshirë gjykimin, arbitrazhin ose shqyrtimin administrativ) nuk është në vazhdim e sipër ose i mundshëm, që nëse do të vendoseshin në mënyrë të pafavorshme për huamarrësit, do të kishin një Efekt Negativ të Konsiderueshëm.

12.6 Mjetet e Sigurimit

Deri në datën e kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi nuk ka vendosur ndonjë Mjet Sigurimi mbi sendet e tij të tashme ose të ardhme pasurore, dhe Huamarrësi nuk ka kryer asnjë veprim, në bazë të të cilit do të vendosej një Mjet Sigurimi mbi sendet pasurore të tashme ose të ardhme të Huamarrësit, përveç sa më poshtë:

i) Mjetit të Sigurimit në favor të Huadhënësit;

ii) Mjetit të Sigurimit të përcaktuar në; dhe

iii) çdo Mjet Sigurimi në formën e të drejtës së mbajtjes që rrjedh nga zbatimi i ligjit dhe në ushtrim të zakonshëm të aktivitetit të Huamarrësit.

12.7 Informacioni i saktë

I gjithë informacioni i dhënë nga Huadhënësi Huamarrësit në lidhje me çdo Dokument Financiar, është i vërtetë dhe i saktë në datën e tij ose (nëse është në informacion ose në lidhje me të i specifikuar) ose në datën e dhënies së tij. Huamarrësi nuk ka lënë informacion të padhënë Huadhënësit i cili, nëse deklarohet, mund të bënte që një pjesë informacioni dhënë Huadhënësit të jetë i pavërtetë ose çorientues në një aspekt të konsiderueshëm.

12.8 Tatimet

Huamarrësi mund të bëjë çdo pagesë sipas çdo Dokumenti Financiar ku ai është palë pa asnjë Zbritje Tatimore.

12.9 Mbrojtja mjedisore

Huamarrësi respekton, në të gjitha aspektet e konsiderueshme, të gjitha ligjet e zbatueshme, vendimet detyruese, rregulloret ose licencat (pavarësisht nga forma ose titulli i tyre) të nxjerra nga autoritetet përkatëse, në lidhje me mbrojtjen mjedisore të mjedisit të cilit i nënshtrohet Huamarrësi.

12.10 Ligji për bankat

a) Huamarrësi nuk ka një raport të veçantë me Huadhënësin sipas seksionit 35 të ligjit për bankat.

b) Huamarrësi nënshkruan çdo Dokument Financiar dhe kryen transaksionet e rëna dakord në çdo Dokument Financiar në emrin e vet dhe për llogari të vet, në pajtim me seksionin 89 të ligjit për bankat dhe ai përdor vetëm fondet në pronësi të tij për të bërë çdo pagesë sipas secilit prej Dokumenteve Financiare.

c) Huamarrësi është informuar për normën vjetore të interesit të shprehur në përqindjen e Garancisë dhe për tarifat që ai do të paguajë sipas kësaj Marrëveshjeje në pajtim me seksionin 37(2) të ligjit për bankat.

12.11 Përsëritja e përfaqësimeve

a) Çdo përfaqësim i përcaktuar në këtë klauzolë konsiderohet të përsëritet nga Huamarrësi në datën e çdo Kërkese dhe gjithmonë në ditën e parë të çdo muaji kalendarik.

b) Nëse një përfaqësim përsëritet sipas paragrafit (a) më sipër, Huamarrësi i konfirmon Huadhënësit që përfaqësimi është i vërtetë dhe i saktë dhe ka të bëjë me rrethanat ekzistuese në momentin e përsëritjes.

13. DETYRIMET PËR INFORMACION

13.1 Pasqyrat dhe llogaritë financiare

a) Huamarrësi duhet t'i paraqesë Huadhënësit:

i) pasqyra financiare individuale të audituara të Huamarrësit (duke përfshirë shënimet) dhe, nëse Huamarrësi ka detyrimin për të konsoliduar pasqyrat e tij financiare (duke përfshirë shënimet), deklarimet e tij financiare të konsoliduara për secilin prej viteve financiare;

ii) pasqyrat e paraprake financiare për çdo gjysmë-viti të parë për çdo vit të veçantë.

b) Secili prej dokumenteve sipas paragrafit (a) më sipër duhet t'i paraqitet Huadhënësit pa vonesë të panevojshme pas përgatitjes së tij por jo më vonë se:

i) në rastin e pasqyrave individuale financiare të audituara të Huamarrësit, 95 ditë;

ii) në rastin e pasqyrave individuale financiare të audituara të Huamarrësit, 180 ditë;

iii) në rastin e pasqyrave individuale financiare paraprake të Huamarrësit, 95 ditë;

nga fundi i periudhës përkatëse financiare për të cilën është përgatitur.

13.2 Forma e pasqyrave financiare dhe llogarive

a) Huamarrësi duhet të garantojë që çdo dokument sipas paragrafit (a) të nënklauzolës të japë një përfaqësim të vërtetë dhe të drejtë të fakteve me të cilat ka të bëjë kontabiliteti i Huamarrësit dhe të rrethanave financiare (të konsoliduara në rastin e një dokumenti të konsoliduar) të Huamarrësit që nga data në të cilën janë përgatitur ato dokumente.

b) Huamarrësi duhet të njoftojë Huadhënësin për:

i) çdo ndryshim në mënyrën në të cilën pasqyrat e audituara financiare individuale dhe/ose pasqyrat e konsoliduara financiare të Huamarrësit përgatiten; dhe

ii) çdo informacion tjetër për t'i mundësuar Huadhënësit të bëjë një krahasim ndërmjet gjendjes financiare të huamarrësit para dhe pas ndryshmit.

13.3 Informacione të ndryshme

Huamarrësi duhet t'i paraqesë Huadhënësit:

i) kopje të të gjithë dokumenteve të rëndësishme që Huamarrësi u jep të gjithë kreditorëve të tij ose një grupi kreditorësh në të njëjtën kohë që ato u dërgohen marrësve të tjerë;

ii) hollësi për një mosmarrëveshje ose procedim të papërfunduar ose të mundshëm (duke përfshirë çdo gjykim arbitrazh ose shqyrtim administrativ) që mund të ketë një Ndikim Negativ të Konsiderueshëm, pa vonesë pasi të vijë në dijeni të këtyre hollësive;

iii) një listë të Personave të tij të Kontrolluar dhe një listë të tij të Personave Kontrollues, pa vonesë pas kërkesës nga huadhënësi për një listë të tillë; dhe

iv) çdo informacion tjetër në lidhje me përmbushjen e detyrimeve të tij sipas një Dokumenti Financiar ose gjendjen financiare të Huamarrësit, pa vonesë pas kërkesës së Huadhënësit për një informacion të tillë.

13.4 Aksesi në informacion

Huamarrësi duhet t'i sigurojë Huadhënësit, pa vonesë pas kërkesës së Huadhënësit, askes në informacion (duke përfshirë aksesin në dokumente, mjediset dhe sendet pasurore të Huamarrësit) të kërkuar nga Huadhënësi me synim konfirmimin e përmbushjes së detyrimeve të Huamarrësit sipas Dokumenteve Financiare dhe verifikuar nëse informacioni i dhënë Huadhënësit është i vërtetë dhe i saktë.

13.5 Njoftimi për Ngjarjen e Qenies në Vonesë

a) Huamarrësi duhet të njoftojë Huadhënësin për çdo Ngjarje të Qenies në Vonesë menjëherë pas ardhjes në dijeni për një ndodhi të tillë.

b) Huadhënësi duhet t'i japë Huadhënësit me kërkesë të Huadhënësit një certifikatë, të nënshkruar nga një person ose persona të autorizuar për të vepruar në emër të tij, duke certifikuar që asnjë Ngjarje e Qenies në Vonesë nuk është efektivisht në fuqi dhe nëse një Ngjarje e tillë është në fuqi, që specifikon Ngjarjen e Qenies në Fuqi dhe hapat që duhen ndërmarrë nga Huamarrësi për ta riparuar atë.

14. DETYRIME TË PËRGJITHSHME

14.1 Të përgjithshme

Huamarrësi bie dakord t'u nënshtrohet detyrimeve të përcaktuara në këtë klauzolë.

14.2 Autorizimet

Huamarrësi duhet të marrë çdo autorizim që kërkohet për të përmbushur detyrimet ose për vlefshmërinë e ekzekutueshmërisë së një Dokumenti Financiar ku ai është palë dhe të sigurojë që një autorizim i tillë të jetë gjithmonë i vlefshëm dhe që termat dhe kushtet e tij (sipas rastit) të respektohen.

14.3 Pengu negativ

a) Përveç kur parashikohet ndryshe në paragrafin (b) më poshtë, Huamarrësi nuk mund të krijojë ose lejojë ekzistencën e një Mjeti Sigurimi mbi sendet e tij pasurore.

b) Paragrafi (a) nuk zbatohet për:

i) asnjë Mjet Sigurimi që krijohet nga çdo Dokument i Mjetit të Sigurimit;

ii) çdo Mjet Sigurimi i renditur në, përveç se në masën në të cilën shuma e principalit e siguruar nga ai Mjet Sigurimi e kalon shumën e përcaktuar në;

iii) çdo Mjet Sigurimi që rrjedh nga zbatimi i ligjit dhe në ushtrim të zakonshëm të aktivitetit të Huamarrësit; ose

iv) çdo Mjet Sigurimi i krijuar me pëlqimin paraprak të Huadhënësit.

14.4 Disponimet

a) Përveç kur parashikohet në paragrafin (b) më poshtë, Huamarrësi nuk mund të disponojë asnjë prej sendeve të tij pasurore.

b) Paragrafi (a) nuk zbatohet për asnjë disponim:

i) të ekzekutuar në vazhdën normale të aktivitetit të subjektit disponues me bazë të pavarur;

ii) të sendeve pasurore në shkëmbim për sende të tjera pasurore të një vlere të lartë; ose

iii) të sendeve pasurore me pëlqimin paraprak të Huadhënësit.

14.5 Gjendja në borxh financiar

a) Përveç kur parashikohet ndryshe në paragrafin (b) më poshtë, Huamarrësi nuk mund të kryejë një transaksion që rezulton ose lejon shkaktimin e një gjendjeje borxhi financiar.

b) Paragrafi (a) nuk zbatohet për:

i) transaksionet që shkaktojnë Gjendje Borxhi Financiar sipas Dokumenteve Financiare;

ii) një transaksion ose transaksione që shkaktojnë Gjendje Borxhi Financiar me pëlqimin paraprak të Huadhënësit;

iii) të kryer në vazhdën normale të aktivitetit.

14.6 Gjendja e detyrimeve

Huamarrësi duhet të garantojë që detyrimet e tij për pagesa që rrjedhin nga Dokumentet Financiare renditen të paktën të barabartë (*pari passu*) me detyrimet ekzistuese dhe të ardhme të pasiguruara të pagesës, përveç për detyrimet që përmbushen në mënyrë preferenciale në bazë të ligjit.

14.7 Ndryshimi i Aktivitetit Kryesor

Huamarrësi duhet të sigurojë që Aktivitetit kryesor të Huamarrësit të mos i bëhet asnjë ndryshim i konsiderueshëm.

14.8 Bashkimi, amalgamimi, ndarja

Huamarrësi nuk mund të futet në asnjë bashkim ose amalgamim me ndonjë person tjetër ose ndonjë ndarje, përveç se me pëlqimin paraprak të Huadhënësit.

14.9 Përftimi

a) Përveç kur parashikohet ndryshe në paragrafin (b) më poshtë, Huamarrësi nuk mund të bëjë asnjë përftim të një interesi pjesëmarrjeje ose aksionesh në një subjekt tjetër juridik, përveç kur kjo bëhet në ushtrim të zakonshëm të aktivitetit.

b) Paragrafi (a) i mësipërm nuk zbatohet për përftimet ku interesi i pjesëmarrjes ose aksionet janë përftuar me pëlqimin paraprak të Huadhënësit.

14.10 Siguracioni

Huamarrësi duhet të sigurojë sendet e tij pasurore dhe detyrimet për aktivitetet e tij në atë masë dhe mënyrë që do të siguronte çdo subjekt i arsyeshëm që zhvillon aktivitetet dhe ka sendet pasurore të krahasueshme ne sendet pasurore të Huamarrësit.

14.11 Akti noterial

a) Përveç kur parashikohet në paragrafin (b) më poshtë, Huamarrësi nuk mund të njohë borxhin e tij kundrejt një personi me një akt noterial të ekzekutueshëm.

b) Paragrafi (a) nuk zbatohet për:

i) një njohje të një borxhi në një akt noterial të ekzekutueshëm në përfitim të Huadhënësit; dhe

ii) një njohje të një borxhi në një akt noterial të ekzekutueshëm i cili ka pëlqimin paraprak të Huadhënësit.

15. NGJARJE TË QENIES NË VONESË

15.1 Ngjarje të Qenies në Vonesë

Secila prej ngjarjeve të parashikuara në këtë klauzolë është një Ngjarje e Qenies në Vonesë pavarësisht nëse Huamarrësi ose një person tjetër mund të ndikojë ndodhinë e saj.

15.2 Mospagesa

Huamarrësi nuk paguan në datën e kërkueshme një shumë të pagueshme prej tij sipas një Dokumenti Financiar në mënyrën e kërkuar sipas Dokumenteve Financiare, përveç kur mospagesa nga Huamarrësi:

i) shkaktohet nga një gabim teknik ose administrativ; dhe

ii) korrigjohet nga Huamarrësi brenda tre Ditëve Pune nga data e kërkueshme.

15.3 Shkelja e detyrimeve të tjera

a) Huamarrësi nuk përmbush asnjë nga detyrimet e veta sipas nënklauzolës, ose klauzolës së kësaj Marrëveshjeje; ose

b) Huamarrësi nuk përmbush një prej detyrimeve sipas një dispozite tjetër të një Dokumenti Financiar ose dispozitë e një marrëveshjeje tjetër të lidhur ndërmjet Huadhënësit dhe Huamarrësit, në pajtim me paragrafin më poshtë.

c) Ngjarja e specifikuar në paragrafin më sipër nuk është Ngjarje e Qenie në Vonesë nëse:

i) mosrespektimi mund të korrigjohet; dhe

ii) ky mosrespektim korrigjohet brenda dhjetë Ditëve Pune nga e para nga ditët e mëposhtme:

A) datë në të cilën Huamarrësi ka marrë njoftim për Ngjarjen e Qenies në Vonesë nga Huadhënësi; dhe

B) data në të cilën Huamarrësi ka ardhur në dijeni të këtij mosrespektimi.

15.4 Keqpërfaqësimi

a) Një përfaqësim i bërë ose i konsideruar të jetë përsëritur nga Huamarrësi në një Dokument Financiar është i pasaktë në datën që është bërë fillimisht ose në datën e përsëritjes së prezumuar, në pajtim me paragrafin më poshtë.

b) Ngjarja e specifikuar në paragrafin më sipër nuk është Ngjarje e Qenie në Vonesë nëse:

i) rrethanat që shkaktojnë keqpërfaqësimin fillestar ose të përsëritur mund të korrigjohen; dhe

ii) këto rrethana korrigjohen brenda dhjetë Ditëve Pune nga e para nga ditët e mëposhtme:

A) datë në të cilën Huamarrësi ka marrë njoftim për Ngjarjen e Qenies në Vonesë nga Huadhënësi; dhe

B) data në të cilën Huamarrësi ka ardhur në dijeni të këtij mosrespektimi.

15.5 Deklarim i paaftësisë paguese

Secila prej ngjarjeve të mëposhtme ndodh në lidhje me Huamarrësin:

i) një prej Borxheve të tij Financiare nuk paguhet kur bëhet i kërkueshëm;

ii) një prej borxheve të tij financiare bëhet para kohe i kërkueshëm dhe i pagueshëm ose mund të bëhet menjëherë i kërkueshëm dhe i pagueshëm pas njoftimit nga huadhënësi si rezultat i shkeljes së detyrimeve të tij nga Huamarrësi; ose

iii) si rezultat i shkeljes së detyrimeve të tij nga Huamarrësi, huaja prishet ose ndodh një transaksion tjetër i ngjashëm që mund të rezultojë ose lejojë ngjarjen e Qenies në Borxh financiar.

15.6 Paaftësia paguese

Secila prej ngjarjeve të mëposhtme ndodh në lidhje me Huamarrësin:

i) është ose për qëllimet e një ligji të zbatueshëm konsiderohet të jetë i mbingarkuar në borxhe ose jo në gjendje të paguajë borxhet nëse bëhen të kërkueshme;

ii) ai pranon para kreditorëve ose një personi tjetër paaftësinë e tij për të paguar borxhet kur ato bëhen të kërkueshme;

iii) ai pezullon bërjen e pagesave për ndonjë prej borxheve të tij ose deklaron synimin e tij ta bëjë këtë; dhe

iv) ai fillon negociimet me një kreditor për riskedulimin e një prej borxheve të tij.

15.7 Fillimi i paaftësisë paguese, pajtimi ose procedime të ngjashme ose likuidimi

a) Përveç kur parashikohet ndryshe në paragrafin (b) më poshtë, një prej ngjarjeve të mëposhtme ndodh në lidhje me Huamarrësin:

i) një person i ndryshëm nga Huamarrësi paraqet një kërkesë për deklarimin e falimentimit mbi sendet pasurore të Huamarrësit ose për fillimin e një procedure tjetër të ngjashme në një vend të caktuar;

ii) Huamarrësi paraqet një kërkesë për deklarimin e falimentimit mbi sendet e tij pasurore, për pajtim (reštrukturalizácia) kundrejt vetes ose për fillimin e një procedimi të ngjashëm në një vend të caktuar;

iii) emërohet një administrator i përkohshëm, administrator paraprak ose administrator i detyruar ose një person tjetër i cili merr të gjitha kompetencat, ose një pjesë të tyre, të organit statutor të Huamarrësit.

b) Paragrafi (a) nuk zbatohet për:

i) depozitimin e një kërkese sipas nënparagrafit (a)(i) më sipër; dhe

ii) Huamarrësi është në gjendje të shlyejë menjëherë shumën për të cilën është paraqitur kërkesa sipas nënparagrafit (a) (i) më sipër dhe paraqet prova për synimin e tij ta bëjë këtë më një depozitim noterial ose një masë tjetër të pranueshme për Huadhënësin.

15.8 Kërkesa për ekzekutimin ose ekzekutimin e vendimit

Një kërkesë për ekzekutim ose një kërkesë për procedime të ngjashme është depozituar ndaj Huamarrësit, qëllimi i së cilës është ekzekutimi i detyruar i një vendimi përfundimtar dhe përbën një Efekt Negativ të Konsiderueshëm.

15.9 Ndërprerja e aktivitetit

Huamarrësi, nëse ka rrethana (që përfshijnë në lidhje me synimin e Huamarrësit) që mund të çojnë në ndërprerje, ndërpret zhvillimin e Aktivitetit të tij Kryesor Tregtar.

15.10 Vlefshmëria dhe efektiviteti i Dokumenteve Financiare

a) Nëse është ose pretendohet nga Huamarrësi që për Huamarrësin të jetë ose të bëhet e paligjshme për Huamarrësin të përmbushë një prej detyrimeve të tij sipas një Dokumenti financiar; ose

b) Një Dokument Financiar nuk është i vlefshëm ose pretendohet nga Huamarrësi të jetë i pavlefshëm për një shkak të caktuar ose Huamarrësi anulon një Dokument Financiar ku ai është palë ose provon synimin e tij për të anuluar një Dokument Financiar ku ai është palë.

15.11 Efekt i konsiderueshëm negativ

Një ngjarje ose sërë ngjarjesh të ndërlidhura ose jo që mund të kenë një Efekt të Konsiderueshëm Negativ.

15.12 Përshpejtimi

a) Nëse ekziston një Ngjarje e Qenies në Vonesë, Huadhënësi, me njoftim drejtuar Huamarrësit, mund të:

i) prishë të Gjithë Angazhimin Financiar ose një pjesë të tij; dhe/ose

ii) deklarojë të gjithë ose një pjesë shumave të pashlyera sipas Dokumenteve Financiare janë:

A) menjëherë të kërkueshëm dhe të pagueshme në vend të një maturimi, siç është rënë dakord fillimisht; ose

B) të pagueshme me kërkesë të parë të Huadhënësit në vend të një maturimi, siç është rënë dakord fillimisht, dhe/ose

iii) kërkojë që të bëhet menjëherë Mbulimi i Shpenzimeve në lidhje me Garancinë e dhënë.

b) Huamarrësi:

i) është i detyruar nga njoftimi i Huadhënësit sipas paragrafit (a) më sipër nga data e bërjes; dhe

ii) duhet të përmbushë të gjitha kushtet dhe kërkesat e Huadhënësit të specifikuara në këtë njoftim.

16. TATIMET

16.1 Përfshirja e tatimeve

a) Huamarrësi duhet ta bëjë çdo pagesë sipas Dokumenteve Financiare pa Zbritur asnjë Tatim, përveç kur Zbritja e Tatimeve kërkohet me ligj.

b) nëse Huamarrësi ose Huadhënësi vijnë në dijeni që Huamarrësi ka një detyrim ligjor të kryejë Zbritjen e Tatimeve ose që normë sipas së cilës duhet të llogaritet Zbritja Tatimore ka ndryshuar, ata duhet të njoftojnë Palët e tjera për këtë pa vonesë të panevojshme.

c) Nëse Huamarrësi është nën një detyrim ligjor për të kryer një Zbritje të Tatimeve:

i) Huamarrësi duhet ta bëjë pagesën e Zbritjes Tatimore brenda kohës së kërkuar nga ligji përkatës; dhe

ii) Huamarrësi duhet të bëjë pagesën tek Huadhënësi në mënyrë të tillë që pagesa të rritet me shumën që do të sigurojë që Huadhënësi merr, pavarësisht zbritjes tatimore, pagesën në atë shumë që ai do të merrte nëse ligji nuk do të vendoste detyrimin mbi Huamarrësin të kryente Mbajtjen Tatimore.

d) Huamarrësi, brenda dhjetë ditëve nga dita në të cilën është bërë e pagueshme Zbritja Tatimore, duhet t'i japë prova Huadhënësit në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Huadhënësin që Zbritja Tatimore është bërë rregullisht dhe që autoriteti përkatës tatimor ka marrë pagesën e Zbritjes Tatimore.

16.2 TVSH-ja

Çdo shumë e pagueshme Huadhënësit sipas Dokumenteve Financiare (duke përfshirë tarifat e Huadhënësit dhe kompensimin për shpenzimet e tij) është e specifikuar në këtë Marrëveshje e lirë nga tatimi mbi vlerën e shtuar, që mund të jetë e pagueshme në lidhje me pagesën e kësaj shume.

Nëse ky Tatim bëhet i pagueshëm, Huamarrësi duhet t'i paguajë Huadhënësit shumën e pagueshme sipas një Dokumenti Financiar duke përfshirë shumën e këtij Tatimi.

17. SHPENZIMET E SHTUARA

17.1 Shpenzimet e shtuara

Huamarrësi duhet t'i paguajë Huadhënësit, me kërkesë të Huadhënësit, shumën e Shpenzimeve të Shtuara, përveç:

i) kur Shpenzimet e Shtuara për Huadhënësin kompensohen sipas një klauzole tjetër të kësaj Marrëveshjeje; ose

ii) nëse Shpenzimet e Shtuara kanë të bëjnë me një shkelje nga Huadhënësi të një ligji ose rregulloreje.

17.2 Njoftimi

Huadhënësi duhet të njoftojë Huamarrësin pa vonesë të panevojshme për çdo rrethanë që justifikojnë Huadhënësin në ngritjen e pretendimit sipas kësaj klauzole dhe të një shume tjetër, nëse është e ditur.

18. DISPOZITA TË NDRYSHME

18.1 Llogaritjet

Çdo shumë interesi ose tarifat sipas kësaj Marrëveshjeje, të përcaktuara si një përqindje në vit, llogaritet mbi bazën e numrit faktik të ditëve të kaluara dhe një vit me 360 ditë, duke përdorur formulën e mëposhtme:

$$P = \frac{A \times D \times R}{360 \times 100}$$

ku:

P është shuma përkatëse e interesit/tarifës;

A është shuma mbi bazën e së cilës llogaritet interesi ose tarifa;

D është numri faktik i ditëve të kaluara; dhe

R është norma e përcaktuar sipas kësaj Marrëveshjeje.

18.2 Ndryshimet e parashikuara të Marrëveshjes dhe heqja dorë nga të drejtat

a) Nëse monedha e Republikës Sllovake ndryshon ose pushon së ekzistuari:

i) kjo nuk përbën shkak për prishjen ose anulimin e një Dokumenti Financiar nga ndonjë prej palëve, për shkak të një ndryshimi në rrethana, paaftësie për përmbushje detyrimi apo tjetër;

ii) Huadhënësi (sipas rastit) përgatit një ndryshim për Dokumentin përkatës Financiar, në një mënyrë që merr parasysh këtë ndryshim dhe, në masën maksimale të mundshme, siguron që pozicioni i palëve për secilin prej Dokumenteve Financiare të jetë identik ose (nëse kjo nuk është e mundur) sa më i ngjashëm të jetë i mundur me pozicionin e tyre para ndodhisë së ndryshimit; dhe

iii) Huamarrësi siguron që me kërkesë të Huadhënësit për një ndryshim, Huamarrësi dhe çdo palë tjetër në Dokumentin Financiar të nënshkruajë pa vonesë të panevojshëm këtë ndryshim me Huadhënësin.

b) Secila Palë bie dakord shprehimisht që nënparagrafët (ii) dhe (iii) të paragrafit (a) më sipër përbëjnë një marrëveshje mbi marrëveshjen e ardhshme me Huadhënësin si përfitues, përmbajtja e së cilës, pavarësisht natyrës së tyre të përgjithshme për shkak të rrethanave sipas të cilave këta paragrafë janë miratuar dhe ku ato zbatohen, janë mjaftueshëm të qarta dhe të sakta.

c) Çdo heqje dorë nga të drejtat nga Huadhënësi është në fuqi vetëm nëse bëhet me shkrim. Çdo vonesë në ushtrim ose mosushtrim i një të drejte të Huadhënësit sipas një Dokumenti Financiar nuk konsiderohet të jetë heqje dorë nga kjo e drejtë dhe nuk rezulton në prishjen e kësaj të drejte.

d) Çdo ndryshim në palët e një Dokumenti Financiar dhe përftim i një të drejte ose detyrimi sipas një Dokumenti Financiar që ndodh në pajtim me dispozitat e tij nuk kërkon hyrjen në fuqi të një amendamenti të atij Dokumenti Financiar.

18.3 Ndryshimet tek Huamarrësi

a) Huamarrësi nuk mund të kalojë ose transferojë të drejta ose të transferojë detyrime që rrjedhin nga Dokumentet Financiare tek një

person tjetër. Për qëllimet e dispozitave të seksionit 151d të Kodit Civil, të gjitha të drejtat e Huamarrësit që rrjedhin nga Dokumentet Financiare nuk janë të transferueshme.

b) Nëse aktiviteti i shpërndarjes së energjisë elektrike të Huamarrësit ndahet nga aktiviteti i shitjes me pakicë të Huamarrësit, në mënyrë të tillë që secili do të kryhet nga një subjekt i ndryshëm juridik, Huamarrësi siguron që subjekti i cili ka licencën e shpërndarjes së energjisë elektrike dhe është pronar i sendeve pasurore të shpërndarjes (nëse bëhet një subjekt i ndryshëm nga Huamarrësi) të aderojë në këtë Marrëveshje dhe bëhet debitor solidar dhe i ndarë së bashku me huamarrësin kundrejt huadhënësit dhe është përgjegjës së bashku me Huamarrësin kundrejt Huadhënësit për pagesën e detyrimeve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje.

18.4 Ndryshimet tek Huadhënësi

a) Huamarrësi bie shprehimisht dakord që Huadhënësi, në çdo kohë dhe pa pëlqim tjetër nga Huamarrësi, mund të transferojë ose kalojë secilën prej të drejtave të tij (duke përfshirë çdo pretendim të tij) dhe në çdo kohë të transferojë çdo detyrim të tij që rrjedh nga një Dokument Financiar tek një person tjetër.

b) Huamarrësi shprehimisht (i) bie dakord që Huadhënësi në çdo kohë dhe pa pëlqim të mëtejshëm nga Huamarrësi, mund të përdorë secilën prej të drejtave të tij (duke përfshirë çdo pretendim të tij) që rrjedh nga një Dokument Financiar si garanci për një detyrim të Huadhënësit; dhe (ii) pëlqimet për çdo ndryshim të personave të autorizuar sipas Dokumenteve Financiare që do të ndodhnin si rezultat i ushtrimit të një të drejte sipas kësaj garancie.

c) Çdo ndryshim i Huadhënësit ose përftim i një të drejte ose detyrimi sipas një Dokumenti Financiar ndaj Huadhënësit hyn në fuqi pas bërjes së një njoftimi të këtij ndryshimi nga Huadhënësi drejtuar Huamarrësit.

18.5 Sekreti dhe konfidencialiteti bankar

a) Huadhënësi është i detyruar ndaj dispozitave ligjore që parashikojnë mbrojtjen e sekretit bankar dhe ka të drejtë të përfitojë nga çdo përjashtim i parashikuar në ato ligje.

b) Pa cenuar paragrafin (a) më sipër, Huamarrësi i jep pëlqimin shprehimisht Huadhënësit për dhënien e informacionit të mbrojtur nga dispozitat përkatëse të sekretit bankar në lidhje me të (duke përfshirë një kopje të çdo Dokumenti Financiar):

i) këshilltarëve profesionistë të Huadhënësit (duke përfshirë këshilltarët ligjorë, kontabilistë, tatimorë dhe të tjerë), të cilat i nënshtrohen detyrimit të konfidencialitetit ose kanë rënë dakord me Huadhënësin ta mbajnë informacionin e dhënë konfidencial;

ii) për qëllimet e çdo procedimi gjyqësor, arbitrazhi, administrativ apo tjetër ku Huadhënësi është palë;

iii) me kusht që personi ka pranuar detyrimin e konfidencialitetit ndaj Huadhënësit:

A) një personi që mund të bëhet përfitues ose i detyruar sipas një Dokumenti Financiar mbi bazën e diskutimeve ose komunikimit tjetër me Huadhënësin;

B) një personi i cili përpunon të dhëna për Huadhënësin;

C) Personit të Kontrolluar dhe/ose Personit kontrollues të Huadhënësit; dhe

D) një personi që është ose vepron si Person i Kontrolluar i Personit kontrollues të Huadhënësit; dhe

iv) bankave, degëve të bankave të huaja dhe Bankës Kombëtare të Sllovakisë nëpërmjet regjistrit të informacionit bankar, me kusht që ata të kenë pranuar detyrimin e konfidencialitetit dhe për pasojë operatorit të këtij regjistri dhe çdo personi tjetër të autorizuar nga operatori për të përpunuar informacionin e regjistruar atje.

c) Huamarrësi duhet të mbajë konfidencial të gjithë informacionin në lidhje me nënshkrimin e Dokumenteve Financiare (duke përfshirë përmbajtjen e çdo Dokumenti financiar) përveç se në rastet e mëposhtme:

i) nëse Huamarrësit i kërkohet me ligj për të dhënë këtë informacion;

ii) nëse informacioni është i disponueshëm publikisht për një shkak të ndryshëm nga shkelja e detyrimit të konfidencialitetit nga Huamarrësi;

iii) nëse informacioni u jepet këshilltarëve profesionistë të Huamarrësit (duke përfshirë këshilltarët ligjorë, kontabilistë, tatimorë ose të tjerë) të cilët i nënshtrohen detyrimit të konfidencialitetit ose kanë rënë dakord me Huamarrësin ta mbajnë informacionin e deklaruar konfidencial.

iv) për synimet e një procedimi gjyqësor, arbitrazhi, administrativ ose tjetër ku Huamarrësi është palë;

v) nëse informacioni është dhënë me pëlqimin e Huadhënësit.

18.6 Ndashmëria e dispozitave

a) Dispozitat individuale të çdo Dokumenti Financiar janë të ekzekutueshme në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra dhe pavlefshmëria e secilës prej tyre nuk ka efekt mbi vlefshmërinë e dispozitave të tjera, përveç rasteve kur natyra thelbësore e tyre ose një rrethanë tjetër në lidhje me këtë dispozitë individuale e bën atë haptazi të pandashme nga dispozitat e tjera përkatëse. Nëse vetëm një pjesë e dispozitës e bën atë të pavlefshme, dispozita zbatohet sikur kjo pjesë të jetë fshirë.

b) Megjithatë, nëse një qëndrim i tillë nuk është i mundur, Palët marrin përsipër të marrin të gjitha masat e nevojshme për të rënë dakord për një dispozitë me efekt të ngjashëm që do të zëvendësojë dispozitën e pavlefshme në pajtim me ligjin përkatës.

18.7 Kopjet

a) Çdo Dokument Financiar mund të përgatitet dhe nënshkruhet në një numër kopjesh.

b) Çdo Dokument Financiar është i nënshkruar në mënyrë të vlefshme edhe nëse nënshkrimet e palëve nuk janë në të njëjtin dokument, përveç kur dispozitat detyruese të ligjit kërkojnë që nënshkrimet të jenë në të njëjtin dokument.

18.8 Gjuha

Çdo Dokument Financiar i nënshkruar është në gjuhën angleze. Nëse përgatitet një përkthim (pavarësisht nëse është i nënshkruar apo jo) dhe ka një mospërputhje ndërmjet tekstit në dy versionet e ndryshme, mbizotëron teksti në gjuhën angleze.

18.9 Komunikimi ndërmjet Palëve

a) Çdo njoftim ose komunikim tjetër formal në lidhje me një Dokument Financiar (duke përfshirë kërkesat) duhet të jetë:

i) me shkrim, i cili, për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, përfshin faksin, e-mailin ose një komunikim tjetër elektronik në masën e rënë dakord nga Palët që dërgojnë dhe marrin korrespondencë dhe duhet të nënshkruhet nga personi i autorizuar;

ii) të jepet personalisht ose dërgohet me shërbim korrieri, postë të regjistruar të klasës së parë ose faks apo e-mail tek pala përkatëse në Dokumentin Financiar si më poshtë:

(A) për Huadhënësin:		**(B) për Huamarrësin:**	
Adresa:	Mlynské nivy 1 829 90 Bratislava	Adresa:	Rruga "Andon Zako Çajupi", Pallati Conad, Kati III, Tirana, Albania
Faks:	+421 2 5055 2082	Faks:	+35542250508
Email:	asandova@vub.sk	Email:	arben.seferaj@oshee.al
Në vëmendje të:	Adriána Sandová / Zuzana Boleková / Zuzana Rovenská	Në vëmendje të:	Arben Seferaj

ose në një adresë tjetër apo numër faksi të njoftuar ndërmjet Huadhënësit dhe Huamarrësit sipas këtij paragrafi (a).

b) Përveç paragrafit (c) më poshtë, çdo njoftim ose komunikim tjetër formal për qëllimet e çdo Dokumenti Financiar konsiderohet të jetë bërë:

i) në datën e dorëzimit, nëse dorëzimi bëhet dorazi ose me shërbim korrieri; ose

ii) në orën 10 00 para dite, në Ditën e dytë të Punës pas ditës së dërgimit, nëse dërgohet me postë të regjistruar të klasës së parë; ose

iii) në datën e transmetimit të mesazhit të faksit, nëse dërgohet në ose para orës 3 00 pas dite, në çdo Ditë Pune; ose në raste të tjera, në Ditën e Punës që është pas datës së transmetimit, nëse dërgohet me faks;

iv) nëse merret në formë të lexueshme kur dërgohet me e-mail.

c) Një komunikim i bërë në pajtim me paragrafin (b) më sipër por i marrë në një Ditë jo-Pune ose pas orarit zyrtar në vendim e marrjes konsiderohet të konsiderohet i dhënë në Ditën pasuese të Punës në atë vend.

d) Çdo kërkesë konsiderohet të jetë bërë në ditën e dorëzimit faktik tek Huadhënësi ose në Ditën e Punës pas ditës së dorëzimit faktik, nëse data e dorëzimit nuk është një Ditë Pune ose nëse Kërkesa është dhënë me faks i dërguar pas orës 3 00 pas ditë në një Ditë Pune.

18.10 Dhënia e konfirmimeve

Secila Palë u konfirmon të gjitha Palëve të tjera që:

i) ka konsultuar ose ka patur një mundësi konsultimi (por ka vendosur për të mos konsultuar) këshilltarët e tij, duke përfshirë këshilltarët e jashtëm kontabilistë ose ligjorë që i konsideron të përshtatshëm, mbi përmbajtën, kuptimin dhe pasojat e dispozitave të çdo Dokumenti Financiar;

ii) ka nënshkruar çdo Dokument Financiar duke i kuptuar plotësisht termat dhe kushtet e saj, dhe asnjë Palë, gjatë negocimeve të një Dokumenti Financiar dhe në momentin e nënshkrimit, nuk ka prezumuar mirëbesim ose detyrim të nënkuptuar ndaj ndonjë Pale tjetër.

18.11 Ligji i zbatuar

a) Kjo Marrëveshje dhe të gjitha detyrimet jokontraktuale ndërmjet Palëve rregullohen nga ligjet e Republikës Sllovake.

b) Pa cenuar ndonjë dispozitë tjetër të kësaj Marrëveshjeje, Palët bien dakord që zbatimi i një dispozite të ligjit sllovak që nuk është rigorozisht detyrues përjashtohet shprehimisht në masën që ai mund të ndryshonte (plotësisht ose pjesërisht) kuptimin ose qëllimin e një dispozite të kësaj Marrëveshjeje.

c) Përveç paragrafit (b), Palët bien dakord që dispozitat e seksionit 361 të Kodit Tregtar nuk zbatohen për këtë Marrëveshje.

d) Për mënjanimin e dyshimit, asnjë e drejtë që mund të jetë në favor të huadhënësit sipas ligjeve dhe rregulloreve nuk cenohet.

18.12 Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje, pretendim ose konflikt që rrjedh nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje (duke përfshirë të gjitha çështjet në lidhje me ekzistencën, vlefshmërinë ose zgjidhjen) zgjidhet nga Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë sipas Rregullave të Arbitrazhit që nëpërmjet kësaj reference bëhen pjesë e kësaj Marrëveshjeje. Vendi i arbitrazhit është në Paris dhe gjuha është ajo angleze. Kjo dispozitë arbitrazhi mund të ekzekutohet veçmas.

18.13 Data i nënshkrimit

Kjo Marrëveshje është nënshkruar në datën e shprehur në fillim të kësaj Marrëveshjeje.

GRAFIKU 1

PËRKUFIZIME DHE INTERPRETIMI

1. Përkufizime

"Ligji mbi Bankat" është ligji nr. 483/2001 Coll për Bankat dhe për Amendimet dhe Plotësimin e Ligjeve të Caktuara, të ndryshuara.

"Periudha e Disponibilitetit" është një periudhë kohe që fillon në datën e kësaj Marrëveshjeje dhe përfundon në Ditën e fundit të Punës të muajit të tretë (3) pas datës së kësaj Marrëveshjeje.

"Ligji i Falimentimit" është ligji nr. 7/2005 Coll. mbi Falimentimin dhe Ristrukturimin, dhe mbi Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve të caktuara, të ndryshuara.

"Ditë Pune" është një ditë (e ndryshme nga e shtuna, e diela ose një festë zyrtare në Bratislavë dhe Tiranë) kur bankat në Republikën Sllovake dhe në Republikën e Shqipërisë janë të hapura për aktivitetin e përgjithshëm dhe që është një Ditë TARGET 2;

"Mbulimi i Shpenzimeve" janë fondet në një shumë të barabartë me shumën e përgjithshme të detyrimit të mundshëm të Huadhënësit sipas Garancisë (përveç kur kjo Marrëveshje parashikon shprehimisht një shumë më të vogël):

a) të cilat depozitohen në një llogari të Huamarrësit që mbahet nga Huadhënësi; dhe/ose

b) që vepron si depozitë sipas Kodit Civil (për të cilën nuk kërkohet llogari depozite);

i) në pajtim me kushtet e mëposhtme:

për qëllimet e paragrafit (a) më sipër:

A) Huamarrësi ka depozituar një shumë të barabartë me Shumën e Garancisë në llogarinë e vet që mbahet tek Huadhënësi, përveç kur kjo Marrëveshje parashikon shprehimisht për një shumë më të vogël;

B) përveç pagesës së dhënë Huadhënësit me qëllim që të shlyhet detyrimi që Huadhënësi i ka dhënë përfituesit sipas Garancisë, Huamarrësi nuk mund të disponojë këto fonde të depozituara derisa Huadhënësit t'i jenë dhënë prova të pranueshme që ai nuk ka detyrime sipas garancisë;

C) Huamarrësi ka krijuar një barrë pengu mbi të arkëtueshmet nga kjo llogari, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Huadhënësin, sipas Marrëveshjes së pengut mbi të

Arkëtueshmet dhe e ka regjistruar atë në Regjistrin Qendror Noterial të Pengjeve; dhe

D) pengu i krijuar sipas nënparagrafit (C) më sipër ekziston si një peng i rangut të parë; dhe

ii) për qëllimet e paragrafit (a) më sipër, Huadhënësi i ka debituar fondet nga llogaria e Huamarrësit që mbahet nga Huadhënësi dhe i ka përdorur ato të krijojë një depozitë (për të cilën Huamarrësi bie dakord shprehimisht), që, me përjashtim të një pagese Huadhënësit për të shlyer detyrimin e Huadhënësit ndaj përfituesit sipas Garancisë, nuk maturohet derisa Huadhënësit t'i jetë paraqitur provë e pranueshme që ai nuk ka asnjë detyrim në bazë të Garancisë;

dhe pretendimi i Huadhënësit për të provuar Mbulimin e Shpenzimeve nga Huamarrësi, është një pretendim i pakushtëzuar i cili shkaktohet duke i bërë njoftimin Huamarrësit sipas klauzolës dhe klauzolës dhe nga ky moment pretendimi është i rikuperueshëm ndaj Huamarrësit (pavarësisht nëse përfituesi pretendon përmbushjen sipas Garancisë).

"Kodi Civil" është Kodi Civil (ligji nr. 40/1964 Coll., i ndryshuar).

"Kodi Tregtar" është Kodi Tregtar (ligji nr. 513/1991 Coll., i ndryshuar).

"Personi i Kontrolluar" është personi i përmendur si personi i kontrolluar në seksionin 66a të Kodit Tregtar.

"Personi Kontrollues" është personi i përmendur si personi kontrollues në seksionin 66a të Kodit Tregtar.

"Aktiviteti Ekonomik Kryesor" është aktiviteti kryesor ekonomik i personit përkatës në datën e kësaj Marrëveshjeje, të regjistruar në regjistrin tregtar (në seksionin në lidhje me aktivitetin ekonomik).

"Euro" është monedha e vetme e shteteve anëtare të Bashkimit Europian që miratojnë ose kanë miratuar euron si monedhën e tyre të ligjshme sipas legjislacionit të Komunitetit Europian të Bashkimit Ekonomik Monetar.

"Ngjarje e Qenies në Vonesë" është një prej ngjarjeve të përcaktuara si të tilla në klauzolën e kësaj Marrëveshjeje ose çdo ngjarje që mund të bëhet ngjarje e qenies në vonesë (p.sh., për shkak të skadimit të një periudhe të caktuar pas ndodhisë së një ngjarjeje të tillë, ose pas njoftimit të saj i cili bëhet nga personi përkatës ose ndryshe).

"Data e Skadencës" është data e specifikuar në Garanci si data e fundit e vlefshmërisë së Garancisë.

"Dokument Financiar" është një prej dokumenteve të mëposhtme:

a) kjo Marrëveshje;

b) çdo Dokument i Mjeteve të Sigurisë; ose

c) çdo dokument tjetër i përcaktuar si i tillë nga Huadhënësi dhe Huamarrësi.

"Borxh Financiar" është një prej sa më poshtë:

a) të gjitha paratë e marra hua ose të pranuara përkohësisht;

b) obligacion, dëftesë premtimi, kambial ose mjet tjetër sigurimi me të cilën lidhet një e drejtë për të kërkuar përmbushjen e një detyrimi financiar, i ndryshëm nga një aksion ose certifikatë aksionesh (që i nënshtrohen paragrafit (c) më poshtë);

c) një aksion, certifikatë aksionesh ose një mjet tjetër sigurimi, pronari i të cilit mund të kërkojë shlyerjen ose një transferim tjetër për shqyrtim nga lëshuesi i tij;

d) një qira financiare ose raport i ngjashëm ligjor ku pronësia transferohet në fund të kësaj mase;

e) çdo e drejtë e transferuar ose e arkëtueshme e ceduar, përveç kur është përjashtuar mundësia e kërkimit nga transferuesi ose ceduesi;

f) çmimi i blerjes së sendeve pasurore, në masën që një shumë e tillë është e kërkueshme dhe e pagueshme pas transferimit të pronësisë së sendeve pasurore ose dorëzimi i sendeve pasurore tek cesionari (p.sh., kredia e furnitorit);

g) një transaksion me derivate që është mbrojtje ndaj luhatjeve në një çmim, normën e këmbimit ose normë tjetër ose ndaj një faktori variabël që i nënshtrohet këtyre luhatjeve;

h) çdo transaksion tjetër (duke përfshirë çdo transaksion që ka të bëjë me një shitje të sendeve pasurore ku sendet pasurore duhet t'i dorëzohen cesionarit pas pranimit të çmimit, si dhe shitja dhe ridhënia me qira) që ka një efekt tregtar të ngjashëm me një pranim të përkohshëm të parave;

i) çdo detyrim i çdo personi për të marrë përsipër të ri-shlyejë lëshuesin e një garancie, letre krediti, zhdëmtimi ose Mjet tjetër të Sigurimit; dhe

j) çdo garanci, zhdëmtim ose Mjet Sigurimi dhënë një personit tjetër në lidhje me një artikull të përmendur në paragrafët (a) deri (i) më sipër.

"Grup" është Huamarrësi dhe Personat e tij të Kontrolluar.

"Garanci" është një dokument Garancie dhe Zhdëmtimi ndërmjet Huadhënësit dhe Huamarrësit në formë dhe përmbajtje të parashikuar në.

"Shuma e Garancisë" është shuma maksimale që Huadhënësi është ose do të jetë i detyruar të paguajë një përfituesi sipas Garancisë përkatëse dhe më vonë Huamarrësi është ose do të jetë i detyruar t'i paguajë Huadhënësit në lidhje me Garancinë përkatëse.

"Angazhimi i Garancisë" është marrja përsipër nga huadhënësi të lëshojë Garancinë në një shumë totale prej deri në Limitin e Garancisë.

"Limiti i Garancisë" është një shumë prej 86.000.000 euro, duke zbritur çdo shumë që është anuluar në pajtim me këtë Marrëveshje.

"Shpenzim i Shtuar" është një shumë e shpenzimeve pasuese ose të shtuara që i ngarkohen Huadhënësit si rezultat i miratimit të rregullave të reja ligjore ose ndryshimeve në rregulloret ekzistuese ligjore ose një ndryshim në interpretimin ose zbatimin e rregulloreve ekzistuese ligjore pas datës së Marrëveshjes.

"Lista e Çmimeve të Huadhënësit" është Lista e Çmimeve të VUB-it a.s. për sipërmarrësit dhe personat juridikë.

"Efekt Negativ i Konsiderueshëm" është një efekt negativ i konsiderueshëm për:

a) gjendjen e biznesit dhe financiare të një anëtari të Grupit dhe Grupin si një i tërë;

b) aftësinë e Huamarrësit për të përmbushur detyrimet sipas një Dokumenti Financiar; ose

c) vlefshmërinë ose ekzekutueshmërinë e një Dokumenti Financiar.

"Palë" është Huadhënësi dhe Huamarrësi.

"Norma e këmbimit" është:

a) norma e këmbimit për shitjen e monedhës përkatëse në pajtim me listën e normave të këmbimit të Huadhënësit në datën përkatëse; ose

b) norma individuale e shkëmbimit e përcaktuar nga Huadhënësi sipas një marrëveshjeje me Huamarrësin.

"Kërkesë" është një udhëzim për lëshimin e një Garancie në formë thelbësisht e parashikuar në ose një kërkesë me shkrim, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Huadhënësin, për një ndryshim në termat e Garancisë.

"Mjet Sigurimi" është:

a) Garancia Sovrane;

b) çdo dokument tjetër i nevojshëm për të krijuar ose dhënë prova për një Mjet Sigurimi mbi një detyrim të Huamarrësit ndaj Huadhënësit.

"Mjet Sigurimi" është një peng, cedim i garancisë për një të drejtë, cedim i garancisë për të arkëtueshmet, e drejta e mbajtjes, ose transferimi apo cedimi me ritransferim ose r-cedim (repo), si dhe çdo marrëveshje ose masë tjetër sipas një ligji që ka një qëllim ose efekt të ngjashëm.

"Marrëveshje Pajtimi" është marrëveshja e pajtimit e lidhur më 23 qershor 2014 ndërmjet, ndërmjet të tjerësh, Huamarrësi dhe CEZ-it a.s., e themeluar dhe regjistruar në Republikën Çeke me numrin e identifikimit të shoqërisë 45274649, zyra e regjistruar e së cilës është në Praha 4, Duhová 2/1444, Kodi Postar 14053, Republika Çeke, regjistruar në Regjistrin Tregtar në Gjykatën e Kryeqytetit në Pragë, seksioni B, hyrja 1581.

"Garanci Sovrane" është garancia sovrane e lëshuar nga Republika e Shqipërisë dhe e aprovuar nga Parlamenti i Republikës së Shqipërisë në favor të Huadhënësit, që garanton detyrimin për pagesë të Huamarrësit kundrejt Huadhënësit në lidhje me Garancinë.

"TARGET" është sistemi i pagesave Trans-European Automated Real-time Gross Settlement Express Transfer, i cili përdor sistemet kombëtare të ndërlidhura në kohë reale dhe mekanizmit të pagesës së Bankës Qendrore Europiane që filloi operimin në datën 4 janar 1999.

"TARGET2" është sistemi i pagesës Trans-European Automated Real-time Gross Settlement Express Transfer, që përdor një platformë të vetme të përbashkët që ka filluar më 19 nëntor 2007.

"Dita TARGET" është:

a) deri në atë moment që TARGET-i mbyllet përfundimisht dhe pushon operacionet çdo ditë në të cilën TARGET dhe TARGET1 janë të hapur për kryerjen e pagesave në euro; dhe

b) deri në atë moment që TARGET-i mbyllet përfundimisht dhe pushon operacionet çdo ditë

në të cilën TARGET2 është i hapur për kryerjen e pagesave në euro; dhe

"Tatim" është çdo tatim, çdo detyrim për të mbajtur ose siguruar këtë tatim ose çdo tarifë, duke përfshirë kamatë-vonesën dhe gjobat për shkeljen e detyrimeve përkatëse.

"Mbajtja e Tatimit" është çdo mbajtje e Tatimit nga një pagesë e bërë sipas Dokumentit Financiar.

"Angazhimi i Financimit Total" është detyrimi i Huadhënësit për t'i dhënë Huamarrësit Përdorimin sipas kësaj Marrëveshjeje deri në Limitin Total të Financimit.

"Limiti Total i Financimit" është Limiti i Garancisë, duke zbritur çdo shumë që është anuluar në pajtim me këtë Marrëveshje.

"Përdorim" do të thotë dhënia e financimit sipas Angazhimit Total të financimit duke lëshuar Garancinë.

"Datë e Përdorimit" është çdo datë në të cilën ndodh përdorimi.

2. Interpretimi

a) Përveç termave të përkufizuar në këtë klauzolë të këtij Grafiku, termat e përdorur në këtë Marrëveshje kanë kuptimet që u vishen atyre në klauzolën ku ato përkufizohen, përveç kur është e qartë nga përkufizimi i një termi që kuptimi i tij është i vlefshëm vetëm për klauzolën përkatëse ose klauzola të tjera të caktuara.

b) Në këtë Marrëveshje, përveç kur shfaqet qëllimi i kundërt:

i) "një diskonim" është një shitje, transferim me shpërblim ose pa shpërblim, shkëmbim, qira, dhënie me shpërblim ose pa shpërblim ose përdorim falas ose një shpërblim tjetër vullnetar ose jo vullnetar (p.sh. në rastin e ekzekutimit të detyruar) dhe disponoj interpretohet përkatësisht;

ii) "një Ngjarje e Qenies në Vonesë" konsiderohet të ndodhë ose të jetë në fuqi nëse nuk është korrigjuar nga Huamarrësi ose nëse huadhënësi nuk ka hequr dorë nga e drejta e tij pas një Ngjarjeje të Qenies në Vonesë;

iii) "çdo referencë tek një person (duke përfshirë një palë)" përfshin trashëgimtarët dhe cesionarët e tij ligjorë në të drejta ose detyrime të cilët janë bërë trashëgimtarë ose cesionarë në të drejta ose detyrime në pajtim me të drejtat dhe/ose detyrimet sipas një marrëveshjeje që ata kanë aderuar;

iv) "çdo referencë tek një Dokument Financiar ose tek një dokument tjetër" do të thotë Dokumenti Financiar përkatës ose një dokument tjetër, që amendohet ose ndryshohet, duke përfshirë në lidhje me rinovimet (novácia);

v) "një dispozitë e ligjit" është një referencë tek ajo dispozitë e zgjeruar, zbatuar, ndryshuar ose rifutur në fuqi dhe përfshin çdo akt nënligjor;

vi) fjalët në njëjës kanë gjithashtu një kuptim në shumës dhe anasjelltas; dhe

vii) çdo referencë tek një klauzolë, nënklauzolë, paragraf, nënparagraf ose grafik është një referencë tek një një klauzolë, nënklauzolë, paragraf, nënparagraf ose grafik i kësaj Marrëveshjeje.

c) Për mënjanimin e dyshimit:

i) në rastin e një përdorimi sipas Angazhimit për Garancinë, pjesët përkatëse të kësaj Marrëveshjeje dhe Kërkesa përkatëse përbëjnë një marrëveshje për të dhënë një garanci;

ii) një detyrim i Huamarrësit sipas një Dokumenti Financiar që nuk është një detyrim pagese mbetet në fuqi për sa kohë që një detyrim pagese i Huamarrësit është ose mund të jetë ose është në gjendje të bëhet i prapambetur sipas Dokumenteve Financiare.

iii) Përmbledhja e termave dhe kushteve bazë të Marrëveshjes në tabelën e dhënë në faqen e parë të kësaj Marrëveshjeje është vetëm për qëllime informimi dhe nuk ka efekte ligjore ndaj Palëve ose ndonjë personi tjetër. Në rastin e mospërputhjes ndërmjet përmbajtjes së kësaj tabele dhe dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje, mbizotërojnë dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

GRAFIKU 2
PARAKUSHTET

Huamarrësi

1. Kopje të dokumenteve organizative të Huamarrësit në tekstin e tyre origjinal dhe në tekstin e tyre të tashëm të plotë ose nëse nënshkrimi i një teksti të plotë nuk është standarde, me ndryshimet e tyre.

2. Kopje të një ekstrakti të përditësuar nga regjistri i shoqërive për Huamarrësin që nuk është më i vjetër se 15 ditë dhe, nëse një informacion i treguar në këtë ekstrakt nuk është i vërtetë, është i paplotë ose i pasaktë, një kopje të të gjitha dokumenteve që provojnë një ndryshim të tillë me

informacionin dhe një kopje të aplikimit për të regjistruar tek regjistri i shoqërive një ndryshim të tillë në informacionin që depozitohet tek autoriteti përkatës.

3. Një kopje e vendimit(eve) të forumeve organizative të Huamarrësit, pëlqimi dhe mendimi i të cilëve kërkohet me ligj ose të dokumenteve organizative të Huamarrësit që kërkohet për të nënshkruar çdo Dokument Financiar ku ai është palë dhe përmbush detyrimet që rrjedhin prej tyre.

Dokumente dhe prova të tjera

4. Prova që tarifa e parë e përpunimit në pajtim me klauzolën dhe tarifën e parë të garancisë në pajtim me klauzolën janë paguar rregullisht.

5. Mendimi ligjor i Kalo & Associates, zyra Tiranë për: (i) ekzekutueshmërinë e Marrëveshjes ndaj Huamarrësit, (ii) cilësinë e përfaqësuesve të nënshkruar për të vepruar në emër të Huamarrësit në lidhje me këtë Marrëveshje, (iii) vlefshmërinë e zgjedhjes së ligjit sllovak.

GRAFIKU 3
MJETET E SIGURIMIT EKZISTUESE

Huamarrësi (emri/nr identifikimi)	Hollësi për Mjetin e Sigurimit (tipi, përshkrimi i sendit pasuror, maturimi i pretendimit të siguruar, hollësi të tjera)	Shuma maksimale e principalit të garantuar

GRAFIKU 4
FORMA E KËRKESËS PËR GARANCI

Nga: (Emri dhe zyra e regjistruar e Huamarrësit)

Nr. i regjistrimit:

Kontakt:

Faks:

Numri i telefonit:

Email:

Drejtuar: Všeobecná úverová banka, a.s.
Mlynské Nivy 1
829 90 Bratislava (VUB)

Sipas termave dhe kushteve të Marrëveshjes për Lëshimin e Garancisë Bankare të datës (Marrëveshja), jeni të lutur të jepni një garanci të pakthyeshme në pajtim me informacionin dhe kërkesat e specifikuara më poshtë.

Termat me germa kapitale të përdorura këtu kanë të njëjtin kuptim si në Marrëveshje.

Në: Gjuhën sllovake Gjuhën angleze

Shuma e Garancisë në euro[1] :

Data e Skadencës së Garancisë[2]:

Në përfitim të përfituesit[3]:

Tipi i garancisë:

Numri dhe data e kontratës:

Lënda e kontratës:

Lëshimi i garancisë në formën e: Garancisë direkte

Teksti i Garancisë: teksti i bashkëngjitur kërkesës dhe/ose Marrëveshjes për Lëshimin e Garancisë Bankare nr..... datë .....

Hollësi të mëtejshme të Garancisë:

Jeni të lutur të dërgoni Garancinë origjinale tek:
ne ne do ta marrim atë personalisht:
me korrier
tek përfituesi
me postë të regjistruar

Ne njohim që ju mund të bëni ndryshime në tekstin e paraqitur të Garancisë si të jetë e nevojshme dhe ju do të konsideroni tekstin e paraqitur të Garancisë si bazë për dhënien e Garancisë vetëm nëse ky tekst është i nënshkruar nga përfaqësuesit tanë (zbatohet vetëm për Garancitë teksti i të cilave korrespondon me tekstin e bashkëngjitur kësaj Kërkese Garancie).

Ne jemi të ndërgjegjshëm që, nëse përfituesi refuzon të paguajë koston jashtë territorit të Republikës Sllovake, ne do të mbulojmë shpenzimet.

në: më:

.....

vula dhe nënshkrimet e përfaqësuesve të Huamarrësit

(emrat dhe titujt e përfaqësuesve ligjorë të Huamarrësit)

Pranuar nga (emri i plotë i punonjësit të VUB-it):

Datë:

Nënshkrimi

[1] Në numra dhe fjalë.

[2] Specifikoni datën dhe skadencës së Garancisë së dhënë.

[3] Specifikoni emrin dhe adresën e plotë të zyrës së regjistruar të përfituesit dhe Iden. Nr.

GRAFIKU 5
EKSTRAKT NGA LISTA E ÇMIMEVE TË HUADHËNËSIT

2.10.1	Garanci me Kërkesë të Klientit	Çmimi €
2.10.1.1	Masa e një detyrimi (përfshirja e një Marrëveshjeje për Lëshimin e Garancisë)	min. 0.40 %, min. € 130.00
2.10.1.2	Garancia e dhënë	nga 0,6 % semestër min. € 120.00
2.10.1.3	Amendim i Marrëveshjes së Lëshimit të Garancisë dhe dokumentacioni përkatës	min. € 199.20
2.10.1.4	Ndryshim në garanci (një shtojcë në garanci ose lëshimi i një garancie të re që zëvendëson të parën)	min. € 99.60
2.10.1.5	Angazhimi për të lidhur një Marrëveshje për Lëshimin e Garancisë	0.5 %, min. € 166.00
2.10.1.6	Përmbushja e Bankës që rrjedh nga një garanci	€ 99.60
2.10.1.7	Anulimi i një garancie para lëshimit të saj	€ 166.00
2.10.1.8	Çdo kujtesë për shumën e papaguar të kërkueshme e dërguar ose për çdo kusht të papërmbushur kontraktual e dërguar	€ 16.60 ose ekuivalenti i monedhës së garancisë
2.10.1.9	Prishja e parakohshme e garancisë (p.sh. lirimi nga përfituesi, kthimi i origjinalit të garancisë bankare), përveç prishjes së parakohshme të vlefshmërisë së garancisë bankare e lëshuar nga banka në lidhje me pjesëmarrjen e një klienti në prokurimin publik.	0.20 % e një shume të garancisë, min. € 100.00
2.16.1.6	Për shërbime të shpejta me mesazh[4]	€ 3.30
2.16.1.9	Shërbim me korrier	kostot faktike, duke përfshirë TVSH-në për inputet[5]

[4] Kompensimi/tarifa i nënshtrohet TVSH-së 20% vetëm nëse këto shërbime përdoren për transaksionet e ngarkuara me TVSH. Nëse ato jepen me një shërbim/aktivitet kryesor të përjashtuar nga TVSH-ja ose nuk i nënshtrohet TVSH-së, këto tarifa janë të përjashtuara nga TVSH-ja.

[5] 1) Çmimi i nënshtrohet TVSH-së 20%.

GRAFIKU 6
FORMA E GARANCISË BANKARE
(vazhdon në faqen tjetër)

NËNSHKRUESIT
Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a.
përfaqësuar nga:
Emri: Arben Seferaj
Titulli: Administrator

Všeobecná úverová banka, a.s.
përfaqësuar nga:
Emri: Vincenzo Petraroli
Titulli: me Prokurë